



© 2012

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare**

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.

Adresa : Rruga "Dora D'Istria", Nr. 10, P.O.Box. 8363, Tiranë

Tel : +355-4-2257560

Faks : +355-4-2250686

E-mail : [amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al)

URL : [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)

# Përmbajtja



## **Fjala Përshëndetëse e Kryetares** **6**

## **PJESA I** **AMF, PREZANTIMI DHE AKTIVITETI** **7**

### **Kapitulli 1** **Organizimi i AMF**

- 1.1 Misioni, objektivat, funksionet themelore 7
- 1.2 Drejtimi dhe organizimi 8
- 1.3 Buxheti 15
- 1.4 Ndryshime në kuadrin rregullues të AMF-së 17

### **Kapitulli 2** **Aktiviteti i AMF** **19**

- 2.1 Aktiviteti rregullator 19
- 2.2 Aktiviteti licencues 23
- 2.3 Aktiviteti mbikëqyrës 31
- 2.4 Teknologjia e informacionit 45
- 2.5 Bashkëpunimi institucional 48
- 2.6 Integrimi Evropian 55
- 2.7 Marrëdhëniet me publikun dhe transparenca 58

### **Kapitulli 3** **Mbrojtja e Konsumatorit** **61**

## **PJESA II** **TREGJET E MBIKËQYRURA** **63**

- II. 1 Tregu i sigurimeve 63
- II. 2 Tregu i letrave me vlerë 74
- II. 3 Tregu i pensioneve private vullnetare 76

## **Sfida dhe prioritete të AMF-së** **78**

## **SHTOJCA** **82**

- A: Struktura e AMF
- B: Kuadri ligjor/rregullativ në sektorin financiar jo-bankar
- C: Lista e institucioneve të mbikëqyrura
- D: Anëtarësime e marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara nga AMF
- F: Treguesit makro ekonomikë

## Fjala Përshëndetëse e Kryetares



Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

### *I nderuar lexues i Raportit Vjetor 2011,*

Përfitoj nga ky rast për të reflektuar, jo vetëm për zhvillimet e vitit 2011, por edhe për ecurinë 5 vjeçare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Prej krijimit të tij në vitin 2006, Autoriteti është përballur vijimësisht me sfida të natyrave të ndryshme, si me atë të integritit të vet institucional, integritimit e përmirësimit cilësor të procesit mbikëqyrës e rregullator të tregut financiar e vendosjes së një standardi, deri te rritja e shkallës së bashkërendimit me autoritetet e tjera financiare. Shtyllat kryesore mbi të cilat është mbështetur zhvillimi institucional i AMF-së kanë qenë:

Hartimi dhe përpunimi i vijueshëm i kuadrit ligjor e rregullativ përkatës me synim krijimin e një baze ligjore e rregullative të plotë, që përafrohet me standardet ndërkombëtare dhe direktivat e BE-së, si dhe i përgjigjet ndryshimeve që pëson tregu financiar në Shqipëri. Në vitin 2011 u përfundua projektligji për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve, që e sjell më afër organizimin dhe funksionimin e tregut të sigurimeve me praktikën evropiane.

Përmirësimi i cilësisë dhe rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes së tregut financiar nëpërmjet zhvillimit dhe përmirësimit të metodologjisë, duke kaluar në mbikëqyrjen me fokus riskun. Kjo qasje e ndryshme mbikëqyrëse gradualisht po shtrihet në tregun e pensioneve dhe të letrave me vlerë.

Trajnimi dhe motivimi i vijueshëm i punonjësve të AMF-së, të cilët sigurojnë rritjen e cilësisë mbikëqyrëse e rregullatore.

Gjatë vitit 2011, Autoriteti u përball me një sfidë të dyfishtë. Në muajin gusht u miratua Ligji nr. 10455, datë 21.07.2011, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Në këtë mënyrë mbikëqyrja e tregut të sigurimeve u rimodelua mbi bazën e risqëve të reja që sillte procesi i liberalizimit. Ndërsa në shtator të vitit 2011, në zbatim të procesit të emërimit të kryer nga Kuvendi, ndryshuan drejtuesit dhe pothuaj krejt Bordi i Autoritetit, duke u përballur me sfidën e ndryshimit të menaxhimit. Mund të them se këto sfida janë përballuar me sukses falë punës së përkushtuar të punonjësve të AMF-së dhe mbështetjes së dhënë nga Bordi i Autoritetit.

Nga ana tjetër, veprimtaria mbikëqyrëse dhe rregullatore e Autoritetit u zhvillua në një situatë ekonomike dhe financiare ku ishin të pranishme shqetësimet si rrjedhojë e ndikimeve të krizës së përgjithshme globale. Prandaj, gjatë vitit 2011, është rritur vigjilenca në procesin mbikëqyrës, si dhe bashkërendimi me autoritete të tjera rregullatore financiare për të nxitur dhe mbështetur qëndrueshmërinë financiare. AMF ka adoptuar filozofinë që nuk duhet të presë që të ndodhin kriza për të përmirësuar metodat e saj mbikëqyrëse, por kërkon të paraprijë në këtë proces duke u bazuar në mësimet e nxjerra nga kriza financiare botërore e këtij viti.

Duke shpresuar që raporti të jetë informues dhe i dobishëm, ju falenderoj për vëmendjen.

*Me konsideratë*  
  
Kryetare

# PJESA I

## AMF, PREZANTIMI DHE AKTIVITETI

- *Mbrojmë konsumatorët*
- *Promovojmë tregjet*
- *Zbatojmë ligjin*

## Kapitulli 1

### Organizimi i AMF

#### 1.1 Misioni, objektivat, funksionet themelore

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si një organizëm rregullator i konsoliduar për të mbikëqyrur tregjet financiare jo-bankare në Shqipëri. AMF është institucion juridik publik i pavarur dhe për veprimtarinë që ushtron në përputhje me këtë ligj, raporton në Kuvend.

#### Subjekte të mbikëqyrura

- Shoqëritë e sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës
- Shoqëritë e risigurimit
- Ndërmjetësit e sigurimeve
- Bursa dhe tregjet e tjera të letrave me vlerë
- Ndërmjetësit financiarë të letrave me vlerë
- Shoqëritë administruese
- Fondet e investimit dhe shoqëritë e investimit
- Fondet e pensionit
- Kujdestar, Depozitar dhe Regjistrar i letrave me vlerë
- Profesionistë të fushave përkatëse

#### Misioni

Misioni i AMF-së është të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregut financiar jo-bankar.

#### Objektivat

Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, AMF udhëhiqet nga këto objektiva:

- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve;
- Nxitja e transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare jo-bankare;
- Sigurimi i respektimit të ligjit.

#### Funksionet themelore të AMF-së

Funksionet kryesore të veprimtarisë së AMF-së janë rregullimi dhe mbikëqyrja e:

- tregut të sigurimeve dhe e veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari;

- tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në letra me vlerë e që veprojnë në këtë treg;
- tregut të pensioneve vullnetare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve vullnetare, të ofruara nga subjektet e licencuara për të operuar në këtë treg;
- veprimtarive të tjera financiare jo-bankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës, që në vijim do të quhen “tregje financiare jo-bankare”.

Funksionet bazë rregullatore-mbikëqyrëse të AMF-së, parashikohen kryesisht në nenin 2 dhe nenin 13 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe përkatësisht në ligjet mbi tregjet e mbikëqyrura. (Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”, Ligji nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.)

Kuadri i ri ligjor në fushën financiare jo-bankare ka konsoliduar më shumë funksionet rregullatore dhe mbikëqyrëse të AMF-së. Këto ligje përmbajnë dispozita të veçanta, të cilat japin një përcaktim më të qartë të funksioneve apo kompetencave që ka Autoriteti.

## 1.2 Drejtimi dhe organizimi

### Bordi i AMF-së

Bordi është organi drejtues dhe vendimmarrës i AMF-së. Të gjithë anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me afat 5 vjeçar. Gjatë vitit 2011 të gjithë anëtarëve të Bordit të AMF-së u përfundoi afati në detyrë. Autoritetet e përcaktuara me ligj, qeveria dhe komisionet kuvendore përkatëse, bënë propozimet për emërimin nga Kuvendi të anëtarëve të Bordit, të cilët u miratuan në Kuvend në periudhën shtator–dhjetor. Për rrjedhojë, Bordi i AMF-së gjatë vitit 2011 pati ndryshime të cilat janë pasqyruar më poshtë:

▪ Elisabeta GJONI	<i>Kryetare</i>	▪ Saimir Sallaku	Anëtar
▪ Enkeleda Shehi	Nënkryetare*	▪ Kestrin Katro	Anëtare*
▪ Enkela Idrizi	Nënkryetare *	▪ Astrit Hado	Anëtar*
▪ Miranda RAMAJ	Anëtare**		

Shënim

\*Emëruar në shtator 2011

Në periudhën janar-shtator 2011, në detyrën e nënkryetares ka qenë Znj. Ermela Guxholli dhe si anëtare e Bordit Znj. Diana Lamani.

\*\*Znj. Miranda Ramaj u riemërua si anëtare e Bordit në dhjetor 2011. Z. Riçard Marku u emërua anëtar i Bordit në dhjetor 2011.



Bordi i AMF-së, në përmbushje të funksioneve të tij gjatë vitit 2011 ka zhvilluar 15 mbledhje dhe ka marrë 187 vendime.

Vendimet e Bordit të AMF-së kanë patur rëndësi në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes e rregullimit të mëtejshëm të tregut financiar jo-bankar si edhe të zhvillimit të tij. Ndër vendimet më të rëndësishme të marra mund të përmendim ato



Bordi i AMF-së

që lidhen me gjallërimin e tregut nëpërmjet licencimit të operatorëve në fusha të ndryshme si: ndërmjetës në sigurime, vlerësues të dëmeve, shoqëri administruese të fondeve të pensioneve dhe të fondeve të investimeve, brokera fizikë dhe shoqëri të brokerimit; si dhe plotësimin e përshtatjen e kuadrit rregullator në të gjitha tregjet e mbikëqyrura, por duke vënë theksin sidomos në fushën e pensioneve private.

Vendimet e lidhura me funksionet mbikëqyrëse përshijnë masa korigjuese dhe sanksione, që kanë synuar parandalimin e situatave jo të përshtatshme, si dhe eliminimin e shkeljeve dhe përmirësimin e tregut financiar jo-bankar. Vendimet e Bordit kanë synuar realizimin e një mbikëqyrjeje efektive të tregut të sigurimeve, letrave me vlerë dhe atij të pensioneve private.

### **Kompetencat kryesore të Bordit të AMF-së**

1. Harton rregullat për përshkrimin dhe qëllimin e punës së çdo departamenti dhe njësie;
2. Harton dhe miraton parimet bazë të veprimtarisë së institucionit;
3. Harton dhe miraton rregulla dhe udhëzime të parashikuara në ligj;
4. Shpërndan udhëzues të shkruar për interpretimin dhe zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore;
5. Lëshon, refuzon, pezullon apo heq licencat për ushtrimin e veprimtarisë në tregun financiar jo-bankar;
6. Kufizon ose ndalon investimet e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, kur ato nuk janë në përputhje me raportet rregullatore apo kur rrezikojnë pozicionin financiar të shoqërisë;
7. Shqyrton kushtet e kontratës së sigurimit, para se ato të hidhen në treg nga operatorët;
8. Miraton pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit dhe të shoqërive të risigurimit;
9. Miraton dhe shpërndan standarde kontabël dhe formatet e raportimit financiar, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të licencuarit;
10. Përcakton politikat e mbikëqyrjes, të kontrollit të subjekteve të mbikëqyrura dhe të zhvillimit të tregut financiar jo-bankar;

- ▶
11. Miraton listën e ekspertëve kontabël për shoqëritë që veprojnë në tregjet financiare jo-bankare;
  12. Miraton çdo vit raportin për industrinë, në lidhje me gjendjen dhe perspektivën e tregut financiar jo-bankar;
  13. Miraton manualet e inspektimit;
  14. Merr vendim për fillimin e procedurave të falimentimit për subjektet e mbikëqyrura dhe emëron likuidatorin;
  15. Miraton projektbuxhetin dhe raportin vjetor të AMF-së;
  16. Merr vendime për lidhjen e memorandumeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritete brenda dhe jashtë vendit;
  17. Vendos për blerjen e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës;
  18. Miraton politikën e pagave dhe të shpërblimeve të punonjësve të AMF-së;
  19. Miraton rregulla për emërimin dhe shkarkimin e punonjësve.

### Struktura organizative e AMF-së


AMF funksionon në bazë të një strukture që miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të Bordit të Autoritetit. Numri i punonjësve sipas strukturës së miratuar në prill të vitit 2007 për AMF-në është 58 dhe prej muajit nëntor të vitit 2010 ky numër nuk është kufizuar më nga ligji për Buxhetin e Shtetit. Për rrjedhojë, numri i të punësuarve në AMF është rritur gradualisht. Kështu, në vitin 2011 shkalla e plotësimit të vendeve të punës në AMF, e matur me numrin e vendeve të punës sipas strukturës së miratuar dhe për të cilat janë punësuar punonjësit, ka arritur në 81%. Rritja e shkallës së plotësimit të vendeve të punës ka ndihmuar në përballimin më cilësor të vëllimit gjithnjë në rritje të aktivitetit të AMF-së në përmbushje të objektivave. Pavarësisht nga kjo, AMF është përballur edhe me fenomenin e largimit të një numri relativisht të konsiderueshëm të punonjësve nga AMF dhe më i pranishëm ky fenomen u vërejt tek aktuarët dhe analistët.

Në AMF, 78% e numrit të punonjësve i përkasin njësive që kryejnë funksione kryesore, të cilat lidhen me detyrat bazë të Autoritetit, licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen. Shpërndarja e punonjësve nëpër njësitë që kryejnë funksione kryesore tregohet në grafikun e mëposhtëm. Në këtë grup janë përfshirë edhe të emëruarit në nivelin e lartë drejtues. Pjesa tjetër, rreth 22% janë punonjës të angazhuar në funksionet mbështetëse, që mundësojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të institucionit.






### Struktura e punonjësve të funksioneve kryesore të AMF-së sipas njësive ku ata punojnë (%)




### Struktura e punonjësve të AMF-së sipas profesionit (%)




AMF kujdeset të ruajë raporte optimale në strukturën e punonjësve bazuar në tiparet e tyre si arsimimi apo moshë. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar punësimit të të rinjve që janë diplomuar apo kualifikuar me rezultate të larta, duke mundësuar pasurimin e mjedisit profesional me përvoja të reja dhe shërbyer si një burim real zhvillimi të punës në Autoritet. Në këtë mënyrë AMF gjykon se ka harmonizuar drejt cilësitë e brezave të ndryshëm dhe ka siguruar transmetim të pandërprerë të njohurive dhe përvojës.

### Struktura e stafit teknik sipas diplomimit



### Struktura e stafit teknik të AMF sipas grupmoshës



Stafi i AMF-së 2011

Struktura aktuale organizative ka mundësuar ruajtjen e një hierarkie të përshtatshme për punonjësit dhe mbulimin e funksioneve të AMF-së. Megjithatë, duke ndjekur zhvillimet në tregun financiar jo-bankar të vendit dhe sfidat që shtrohen për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tij, sidomos në kushtet e krizës globale financiare, Banka Botërore (BB) dhe Komisioni Evropian (KE) në mënyrë të vazhdueshme kanë vënë theksin në forcimin e kapaciteteve administrative të AMF-së. Këto rekomandime që përmbahen në raportet

e misionit të asistencës teknike të BB-së dhe në raport progresin e Komisionit Evropian kanë të bëjnë me sigurimin e një strukture organizative fleksibël që t'i përshtatet prirjeve të zhvillimit të tregut që mbikëqyr, me tërheqjen, mbajtjen dhe trajnimin e punonjësve të aftë e me integritet dhe me kualifikimin e vazhdueshëm të tyre. Bazuar në këto rekomandime,



gjatë vitit 2011, Autoriteti ka paraqitur pranë Kuvendit të Shqipërisë propozimin për disa ndryshime strukturore të tij, si edhe po punon për propozimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore.

### Politikat e Burimeve Njerëzore

Drejtimi i burimeve njerëzore në AMF realizohet në përputhje me misionin dhe objektivat strategjike të tij. Në planin afatshkurtër vëmendja e sektorit të burimeve njerëzore u përqendrua në:

- nxitjen dhe motivimin e punonjësve;
- trajnimin e mëtejshëm e sa më të plotë të punonjësve;
- punësimin e burimeve njerëzore gjithnjë e më cilësore.

AMF gjatë vitit 2011 miratoi dokumentin “Politika e Burimeve Njerëzore” ku përvijohen parimet e përgjithshme në bazë të të cilave Bordi i AMF-së kërkon të drejtohen burimet njerëzore në institucion. Dokumenti u materializua edhe me Kodin e Etikës, Rregulloren e Marrëdhënieve të Punës dhe Rregulloren e Marrëdhënieve Financiare me punonjësit e AMF-së, të gjitha të miratuara gjatë vitit 2011.

Ndikim në rritjen e efektivitetit në punë ka dhënë edhe procesi i vlerësimit të arritjeve individuale të punonjësve, si pjesë e politikës nxitëse dhe motivuese për ta.

### Kualifikimi profesional

Në përmbushje të rekomandimit për forcimin e kapaciteteve administrative, AMF gjatë vitit 2011 ka patur në vëmendje hartimin e programeve të kualifikimit të punonjësve mbështetur në dy nivele:

- trajnimin bazë për punonjësit e punësuar rishtazi në institucion,
- kualifikimin profesional për pjesën tjetër të punonjësve.

Programi i trajnimeve është ndërtuar në përshtatje me objektivat e institucionit dhe objektivat individuale për punonjësit. Aktivitetet e realizuara për vitin 2011, brenda dhe jashtë vendit, kanë konsistuar në pjesëmarrje në trajnime, seminare, konferenca, takime, si dhe vizita në shkëmbimin e përvojave më të mira profesionale, mbështetur në asistencën e institucioneve prestigjioze ndërkombëtare në fushën financiare si: Banka Botërore, Këshilli i Evropës, USAID nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Sektorit Financiar në Shqipëri si edhe shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve, Shoqata Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS); Organizata Ndërkombëtare e



Gjatë testimit të vlerësuesve të dëmeve në sigurime



Aktuarët profesionistë në ceremoninë e diplomimit të programit të trajnimit dhe certifikimit të tyre

Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (IOSCO); Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Pensioneve (IOPS); Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve e SHBA-së (NAIC), etj.

Gjatë vitit 2011, rreth 75% e punonjësve të funksioneve kryesore të AMF-së kanë marrë

pjesë aktive në seminare, trajnime e konferenca të lidhura me fushat përkatëse. Në nivel institucioni çdo punonjës është trajnuar mesatarisht për një javë.

Edhe gjatë vitit 2011, AMF ka vazhduar nxitjen e kualifikimit edhe nëpërmjet financimit tërësor ose pjesor të specializimeve të profilizuara veçanërisht në drejtime që lejojnë realizimin me sukses të detyrave dhe objektivave të institucionit. Kështu, me qëllim rritjen e ekspertizës profesionale, AMF mundësoi mbështetjen e disa punonjësve për përfundimin në muajin maj të kursit të dytë të trajnimit të aktuarëve profesionistë, ndjekjen e studimeve pasuniversitare në drejtimin financë, kontabilitet, etj. Nga ana tjetër, nxitja dhe mbështetja e punonjësve të institucionit nëpërmjet kualifikimit u ka dhënë atyre mundësi për të rritur aftësitë e tyre profesionale, për të përfaqësuar me kompetencë Autoritetin në nivele më të gjera si dhe ka rritur profesionalisht burimet njerëzore të institucionit.

### Auditimi i brendshëm

Kuadri rregullator për funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në AMF u plotësua gjatë vitit 2011 edhe me dy dokumente të tjera. Kështu, u miratua Karta e Auditimit të Brendshëm si edhe Kodi i Etikës së audituesit të brendshëm për AMF-në, dokumente këto të hartuara në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm (shpallur

### Programi Kualifikues “FSI Connect”

AMF, në mbështetje të politikës së trajnimit të punonjësve në vitin 2011, mundësoi një alternativë të re trajnimi e cila ka filluar të përdoret gjerësisht nga mbikëqyrësit e sektorit financiar në botë. Ky program trajnimi përdoret nga rreth 8000 punonjës të autoriteteve mbikëqyrëse në botë.

“FSI Connect” është një program trajnimi *on line* dhe burim informacioni për punonjësit e autoriteteve rregullatore të sektorit financiar, organizuar që prej vitit 2004 nga ekspertë me përvojë të Institutit të Stabilitetit Financiar (FSI), me qendër në Zvicër.

“FSI Connect” ofron mbi 200 leksione *on line* të cilat përditësohen në mënyrë të vazhdueshme. Autoriteti ka mundësuar abonimin e 5 përdoruesve nga punonjësit e tij. Nëpërmjet këtij instrumenti trajnues, AMF synon përmirësimin dhe zhvillimin e aftësive profesionale të punonjësve të saj në të gjitha nivelet në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve.



nga Instituti ndërkombëtar i Audituesve të Brendshëm).

Në vitin 2011, Njësia e Auditimit të Brendshëm është angazhuar në auditimin e 12 objekteve, që përfaqësojnë 100% të detyrave të planifikuara. Funkzioni i auditimit të brendshëm vijon të kryhet nga një specialist auditimi, me një përvojë pune 5-vjeçare pranë AMF-së dhe i pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm të sektorit publik. Në bazë të gjetjeve të auditimeve të kryera, gjatë vitit 2011, janë dhënë 13 rekomandime, të cilat u janë raportuar njësive të audituara si dhe Bordit të AMF-së.

Në vitin 2011, Njësia e Auditimit të Brendshëm iu nënshtrua vlerësimit të cilësisë së punës audituese nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Ministrisë së Financave për “Auditimin e Brendshëm” e cila konkludoi se veprimtaria e auditimit të brendshëm në AMF i ka shërbyer pozitivisht realizimit të objektivave të vetë strukturës, por edhe atyre të institucionit në përgjithësi.

### **Arkiv - Protokoli**

Korrespondenca zyrtare e AMF-së trajtohet në zyrën e Arkiv-Protokollit. Gjatë vitit 2011 janë përpunuar rreth 4,024 praktika. Pjesa më e madhe e tyre janë praktika që Autoriteti i ka nxjerrë në drejtim të palëve të interesit, ndërsa pjesa tjetër është informacion si edhe përgjigjet që AMF-së i janë kërkuar nga institucione të ndryshme. Në Autoritet kanë ardhur 1,713 praktika si përgjigje nga palët e interesit dhe institucionet e ndryshme shtetërore dhe private. Ndërsa korrespondenca e brendshme në AMF përmban 1,300 komunikime të tilla.

### **1.3 Buxheti**

AMF-ja është institucion i pavarur, që financohet kryesisht nga burimet e veta. Që prej vitit 2009, AMF ka siguruar financim tërësor nga burimet e veta dhe nuk merr më financim nga buxheti i shtetit.

Burimin kryesor të të ardhurave të AMF-së e përbëjnë të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e saj. Në vitin 2011, AMF trashëgoi edhe të ardhura nga viti 2010, të cilat ishin të destinuara për të financuar investimet e parashikuara në po atë vit. Të ardhurat gjithsej të AMF-së për vitin 2011 janë realizuar në masën 132.7 milionë lekë ose 3.6% më shumë nga plani. Të ardhurat nga veprimtaria e vitit zënë rreth 95.3% të të ardhurave gjithsej. Ky grup të ardhurash është realizuar në masën 126.5 milionë lekë ose 3.8% më shumë nga plani. Kontributi kryesor brenda grupit të të ardhurave të veprimtarisë i përket të ardhurave të përftuara nga kontributet e paguara prej subjekteve të tregut të sigurimeve, të cilat përbëjnë 95.8% të të ardhurave të veprimtarisë ose 91.3% të të ardhurave gjithsej. Niveli i realizimit të të ardhurave nga këto kontribute është rreth 3.8% më shumë sesa plani.

**Tabelë 1: Burimet e fondeve të AMF-së**

<i>Emërtimi</i>	<i>Vlera në Lekë</i>
1. Të ardhura nga veprimtaria	126,499,890
1.1 Të ardhura nga kontributet e shoqërive të sigurimit	121,144,579
1.2 Të ardhura nga subjektet që operojnë në tregun e letrave me vlerë	1,605,500
1.3 Të ardhura nga subjektet që operojnë si shoq. admin. pensioneve vullnetare	773,542
1.4 Të ardhura nga licencime, etj	2,826,924
1.5 Të ardhura nga gjoba e interesa bankare	149,345
2. Financime të mbartura për investime në proces	6,258,655
<b>TOTALI</b>	<b>132,758,545</b>

**Tabelë 2: Përdorimi i fondeve të AMF-së**

<i>Emërtimi</i>	<i>Vlera në Lekë</i>
1. Shpenzime funksionimi	94,471,031
1.1 Paga, shpërblime, sigurime shoqërore	59,657,130
1.2 Shpenzime operative	34,813,901
2. Investime	11,214,938
3. Fonde të regjistruara për periudhat e ardhshme	27,072,576
<b>TOTALI</b>	<b>132,758,545</b>

Të ardhurat e AMF-së kanë dy përdorime kryesore:

- Financimin e shpenzimeve të funksionimit;
- Financimin e shpenzimeve të investimit.

Gjatë vitit 2011, të ardhurat e përdorura gjithsej ishin 105.7 milionë lekë ose 83% e planit. Shpenzimet e funksionimit përbëjnë përdorimin kryesor të të ardhurave të AMF-së, duke zënë 89.4% të shpenzimeve gjithsej. Për vitin 2011 ato janë realizuar në masën 94.5 milionë lekë ose 13.6% më pak sesa plani. Shpenzimet për investime në vitin 2011 janë realizuar në masën 11.2 milionë lekë ose 34.6% më pak sesa plani.



Shpenzimet për investime janë orientuar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike, me synim rritjen e cilësisë së mbikëqyrjes së AMF-së në tregun financiar jo-bankar dhe në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës së punonjësve. Kështu, në projektet e ndryshme të lidhura me Teknologjinë e Informacionit peshën kryesore, rreth 40%, e ka zëri “Sistemi i administrimit të informacionit”, (Management Information System), nëpërmjet të cilit kryhet raportimi elektronik i detyrimeve ligjore të subjekteve të mbikëqyrura nga AMF dhe që është përgatitur me financimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, BERZH. Duke filluar nga viti 2011, AMF përballon me të ardhurat e realizuara nga veprimtaria, kontratat e mirëmbajtjes me firmën zhvilluese “VIZOR”.

Në zbatim të planit të investimeve, AMF ka hartuar e zbatuar edhe planin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2011, përmbante 7 procedura prokurimi, ndërsa mbulimi i nevojave të tjera është realizuar me prokurime me vlera të vogla. Vlen të theksohet realizimi me sukses i 4 procedurave të prokurimit, ndërkohë që për mungesë konkurrence janë anuluar 3 procedura të tilla. Fondi i parealizuar për mungesë konkurrence, në vitin 2011 ka qenë në masën 4.28 milionë lekë të planifikuara për blerjen e pajisjeve. Mosrealizimi i këtyre tenderimeve nuk e ka vënë në rrezik kryerjen e detyrave. Sigurisht, që ato kanë qenë e janë pajisje të nevojshme për AMF-në për të cilat pritet të kryhen procedurat tenderuese në periudhën vijuese.

Prej vitit 2007 e në vazhdim, pasqyrat financiare vjetore të AMF-së auditohen nga ekspertë kontabël të autorizuar, pavarësisht se një gjë e tillë nuk buron nga detyrime ligjore. Raportet e dorëzuara nga ekspertët kanë vlerësuar korrektësinë në mbajtjen e këtyre pasqyrave.

#### 1.4 Ndryshime në kuadrin rregullues të AMF-së

Gjatë vitit 2011, Bordi i AMF-së ka miratuar një sërë rregulloresh të reja dhe ndryshimesh në ato ekzistueset që janë të lidhura me funksionimin institucional dhe vetë aktivitetin e AMF-së si institucion. Ndër më të rëndësishmet veçojmë:

Rregullore nr. 37/1, datë 23.02.2011, **“Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në AMF”**, e cila ka për qëllim përcaktimin e rregullave për kushtet, procedurat, të drejtat dhe detyrimet, e pranimit, fillimit, vazhdimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës së punonjësve në AMF.

Rregullore nr. 37/2, datë 23.02.2011, **“Kodi i etikës në AMF”**, e cila ka si qëllim që të shërbejë si udhëzues për të gjithë punonjësit e Autoritetit, lidhur me veprimet e përditshme apo me vendimmarrjen në përputhje me misionin, parimet drejtuese dhe vlerat e punonjësve. Kodi i Etikës shërben si një urë lidhëse ndërmjet integritetit personal e profesional në veprimet e përditshme të punonjësve dhe shpreh angazhimin e tyre ndaj Misionit të Autoritetit.

Rregullore nr. 56, datë 30.03.2011, **“Për funksionimin dhe administrimin e ambienteve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”**, e cila ka për objekt përcaktimin e rregullave për funksionimin, administrimin, sigurinë, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e ambienteve të punës dhe pajisjeve në AMF. Kjo rregullore është ndryshuar me vendim Bordi nr. 99 datë 28.07.2011.

Rregullore nr. 83, datë 29.06.2011, **“Për marrëdhëniet financiare të punonjësve me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”**, e cila ka për qëllim përcaktimin e rregullave që disiplinon mënyrën e përcaktimit dhe masën e shpenzimeve që kryhen për punonjësit e AMF-së. Ndryshimi i kësaj rregullore është miratuar me vendim Bordi nr. 103 datë 28.07.2011.

Ndryshim në rregulloren nr. 7, datë 30.08.2007, **“Për rregullat e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”**, miratuar me vendim Bordi nr. 100 datë 28.07.2011 dhe nr. 144 datë 27.10.2011.

Rregullore nr. 118, datë 19.09.2011, **“Karta e auditimit të brendshëm”**, e cila përcakton misionin, qëllimin, objektivat e punës dhe përgjegjësitë e funksionit të auditimit të brendshëm në Autoritet, të përcaktuara në përkufizimin, standardet ndërkombëtare dhe kodin e etikës, që drejtojnë praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Rregullore nr. 119, datë 19.09.2011, **“Kodi i etikës së audituesit të brendshëm”**, e cila ka për qëllim të promovojë një kulturë etike në ushtrimin e auditimit të brendshëm.

Rregullore nr. 177, datë 13.12.2011, **“Mbi organizimin e veprimtarisë kërkimore në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”**, e cila ka për objekt të përcaktojë normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin e veprimtarisë kërkimore në AMF, detyrat funksionale të përgjithshme dhe të veçanta të çdo individi dhe njësie që angazhohet në këtë veprimtari.



## Kapitulli 2 Aktiviteti i AMF



### 2.1 Aktiviteti rregullues

Gjatë vitit 2011, një ndër prioritetet kryesore të AMF-së, ka qenë hartimi dhe miratimi i legjislacionit rregullator dhe mbikëqyrës në fushën e shërbimeve financiare jo-bankare. Autoriteti, prej 4 vitesh, ka punuar për zbatimin e metodologjisë së re të mbikëqyrjes me fokus riskun dhe hartimin e **projekt ligjit të ri mbi veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve**. Ky dokument, që pritet të miratohet në **2012**, së bashku me aktet nënligjore, do të krijojë hapësirat e nevojshme ligjore për zbatimin e metodologjisë së re.

Në kuadër të përmirësimit të akteve ligjore ekzistuese dhe përafrimit të tyre me direktivat e BE-së, AMF hartoi 22 rregullore të reja dhe realizoi ndryshime në disa rregullore të tjera të mbikëqyrjes financiare jo-bankare.

#### Aktet nënligjore në fushën e sigurimeve

Për vitin 2011, zhvillimi kryesor legjislativ ka qenë hartimi i projektligjit **“Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”**. Ky projektligj u hartua nga Autoriteti në përputhje me direktivat e BE-së me qëllim forcimin dhe zhvillimin e sektorit të sigurimeve në vend. Procesi i hartimit përfundoi në dhjetor 2011 dhe është rezultat i punës disa vjeçare të AMF-së për plotësimin e kuadrit ligjor dhe angazhimeve për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së. Hartimi i këtij projektligji është bërë nga AMF në bashkëpunim me ekspertë të BB. Krahas këtij, gjatë vitit 2011, AMF ka hartuar apo ndryshuar e miratuar një numër rregulloresh në mbështetje të objektivave afatmesëm për mbikëqyrjen me fokus risku dhe sistemin e menaxhimit të informacionit.

Ndër aktet e reja nënligjore përmendim:

Rregullore nr. 26, datë 23.02.2011, **“Mbi funksionimin e sistemit të raportimit AMF In-Reg”**, e cila ka për objekt organizimin, funksionimin dhe përcaktimin e procedurave të sistemit të raportimit AMF In-Reg.

Rregullore nr. 110, datë 28.07.2011, **“Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”**, e cila përcakton nivelin e provigjoneve teknike, përmbajtjen e bazës teknike të të dhënave, metodikën për përlogaritjen e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

Gjithashtu, janë bërë edhe ndryshime në rregulloret ekzistuese:

Rregulloren nr. 36, datë 30.04.2009, **“Për regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike”**, ndryshim i miratuar me vendim Bordi nr. 79 datë 29.06.2011. Kjo rregullore është ndryshuar e miratuar sërish me vendim Bordi nr. 148 datë 23.11.2011

Rregulloren nr. 67, datë 27.07.2009 **“Mbi licencimin e aktuarëve të autorizuar të shoqërive të sigurimit”**, ndryshim i miratuar me vendim Bordi nr. 76, datë 29.06.2011.

Rregulloren nr. 7, datë 08.02.2007, **“Për ekspertët kontabël të regjistruar të shoqërive të sigurimit”**, ndryshim i miratuar me vendim Bordi nr. 98 datë 28.07.2011.

Rregulloren nr. 3, datë 03.10.2007, **“Për Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik”**, ndryshim i miratuar me vendim Bordi nr. 107 datë 28.07.2011.

Rregulloren nr. 9, datë 08.02.2007, **“Mbi bazat, metodat e llogaritjes, si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të Jo-Jetës”**, ndryshim i miratuar me vendim Bordi nr. 146 datë 27.10.2011.

Rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009, **“Për trajtimin e dëmeve që mbuloohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”**, ndryshim i miratuar me vendim Bordi nr. 168 datë 13.12.2011.

### **Aktet nënligjore në fushën e letrave me vlerë**

Arritjet legislative për vitin 2011 në fushën e titujve u konkretizuan me miratimin e rregullave të reja për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të hartuara në zbatim të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Rregullore nr. 68, datë 26.05.2011, **“Për dhënien e licencës, veprimtarinë tregtare, ofertën publike dhe kërkesat e raportimit për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike të krijuar nga një shoqëri e huaj administruese”**, e cila përcakton dokumentacionin shtesë për dhënien e licencës për sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike të krijuar nga një shoqëri e huaj administruese, si dhe kërkesat për veprimtarinë tregtare, ofertën publike dhe mënyrën e raportimit.

Rregullore nr. 69, datë 26.05.2011, **“Për autorizimin e individëve për shitjen e kuotave apo aksioneve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike”**, e cila përcakton kushtet, mënyrën e autorizimit për shitjen e kuotave/aksioneve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, për individët e punësuar të një agjenti të shoqërisë administruese, si dhe agjentët-individë, të cilët veprojnë për llogari të shoqërisë administruese sipas një kontrate të veçantë.

Rregullore nr. 77, datë 29.06.2011, **“Mbi përcaktimin e vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve të tyre për kuotë ose për aksion”**, e cila përcakton bazën e detyrueshme për përcaktimin e



vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, duke përfshirë letrat me vlerë, paranë dhe ekuivalentet e saj, valutën e huaj, transaksionet me kontratat e të ardhmes (future), kontratat e mundësive (option) dhe derivativët e tjerë, pasuritë e paluajtshme, pronat e shoqërisë (në rastin e shoqërisë së investimit) ose të drejta të tjera pronësie të transferueshme.

Rregullore nr. 78 datë 29.06.2011, **“Mbi përmbajtjen e regjistrit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”**, e cila përcakton përmbajtjen e regjistrave të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, të cilat mbahen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Rregullore nr. 127, datë 06.10.2011, “Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve”, e cila përcakton përmbajtjen minimale, afatet dhe formën e raporteve të detyrueshme të dorëzuara në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Rregullore nr. 128, datë 06.10.2011, **“Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”**, e cila ka si qëllim përcaktimin e procedurave dhe kërkesave shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Rregullore nr. 129, datë 06.10.2011 **“Mbi procedurat, kostot dhe afatet kohore për mbylljen e fondeve të investimeve”**, e cila përcakton procedurën, kostot dhe afatet kohore për mbylljen e një fondi investimesh.

Rregullore nr. 130, datë 06.10.2011, **“Për regjistrin e investitorëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”**, e cila përcakton rregullat për formën dhe përmbajtjen e të dhënave të regjistrit të investitorëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, i cili krijohet dhe mbahet nga depozitari.

Rregullore nr. 131, datë 06.10.2011, **“Mbi kodin e sjelljes të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”**, e cila ka për qëllim të rregullojë sjelljen dhe kushtet për kryerjen e veprimtarisë të shoqërive të administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, me qëllim garantimin e kryerjes sa më efektive të veprimtarisë dhe uljen në minimum të rrezikut të biznesit.

Gjatë vitit 2011 ky treg njohu zhvillime pozitive në drejtim të licencimit. Autoriteti licencoi shoqërinë e parë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive si dhe miratoi emetimin e parë të obligacionit me ofertë private.

Reformat ligjore, përmirësimi i standardeve dhe rritja e cilësisë së mbikëqyrjes pritet të kenë ndikim pozitiv në rritjen e mëtejshme të interesit nga investitorët e huaj prestigjiozë për tregjet financiare jo-bankare në Shqipëri.

## Aktet nënligjore në fushën e pensioneve

Oë nga hyrja në fuqi e Ligjit të ri nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, tregu i pensioneve vullnetare njohu zhvillime relativisht pozitive në drejtim të licencimit. Autoriteti ka miratuar dhënien e licencës për 3 shoqëri administruese të fondeve të pensioneve vullnetare dhe licencën për 3 banka si depozitar të fondeve të pensioneve.

Shoqëritë e licencuara pritet të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tregut të pensioneve vullnetare dhe në rritjen e besueshmërisë së individëve dhe bizneseve për të përfshirë punonjësit e tyre në skemën e pensioneve vullnetare. Skema e re e organizimit dhe funksionimit të pensioneve vullnetare, përbën një risi për tregun financiar shqiptar. Për më tepër, përfshirja e lehtësirave tatimore në këtë ligj, e ka bërë skemën e pensionit privat më tërheqëse për kontribuesit dhe punëdhënësit, zbatimi i të cilave ende nuk ka gjetur hapësirat e nevojshme në legjislacionin tatimor.

Autoriteti, gjatë 2011, ka vazhduar forcimin e bazës rregullative me hartimin dhe miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të ligjit për pensionet vullnetare.

Rregulloret e miratuara janë si më poshtë:

Rregullore nr. 1 datë 13.01.2011, **“Për delegimin e funksioneve të shoqërisë administruese të fondeve të pensioneve”**, e cila ka për qëllim të përcaktojë llojet e funksioneve, rregullat dhe procedurat për delegim të funksioneve nga shoqëria administruese te palët e treta.

Rregullore nr. 2 datë 13.01 2011, **“Për përmbajtjen e kontratës dhe të prospektit të fondit të pensionit”**, e cila përcakton rregulla më të hollësishme të përmbajtjes së kontratës dhe prospektit të fondit të pensionit vullnetar.

Rregullore nr. 24 datë 23.02.2011, **“Mbi ndarjen e veprimtarive të shoqërisë administruese të fondit të pensionit vullnetar”**, e cila përcakton kriteret dhe standardet për ndarjen e veprimtarisë së administrimit të fondit të pensionit, nga veprimtaria e administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, në rastin kur të dy veprimtaritë kryhen nga e njëjta shoqëri administruese e licencuar.

Rregullore nr. 25 datë 23.02.2011, **“Për raportimin në AMF të veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit”**, e cila ka për qëllim të rregullojë përmbajtjen, shpeshësinë, afatet dhe formën e pasqyrave financiare të detyrueshme për tu depozituar nga shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve, në Autoritet.

Gjithashtu, janë bërë edhe ndryshime në rregulloren ekzistuese nr. 18/1, datë 25.02.2010 **“Tarifat e licencimit dhe funksionimit të shoqërisë administruese, depozitarit dhe agjentit të fondeve të pensionit vullnetar”**, ndryshim i miratuar me vendim bordi nr. 134 datë 06.10.2011 dhe vendim bordi nr. 184 datë 13.12.2011.



## 2.2 Aktiviteti licencues

Gjatë ushtrimit të kompetencave të veta në procesin licencues, AMF është kujdesur që kërkesat dhe procedurat e licencimit të zbatuara për subjektet që kërkojnë të ushtrojnë aktivitet në tregun financiar jo-bankar, të jenë të qarta, objektive dhe transparente, duke e vënë theksin:

- në gjendjen e shëndoshë financiare të aplikantit;
- në aftësitë profesionale dhe të besueshmërisë të drejtuesve dhe vendimmarrësve të aplikantit;
- në hartimin e strukturave të përshtatshme të mënyrës së qeverisjes së aplikantit;
- në paraqitjen e planeve financiare dhe të biznesit në mënyrë sa më të qartë dhe të argumentuar.

AMF, në ushtrimin e funksionit licencues, ka synuar drejt një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar.

Risia e këtij viti, në aspektin licencues, ka qenë licencimi i shoqërisë “Raiffeisen Invest-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a. Kjo Shoqëri u licencua për të kryer veprimtari administrimi të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, krahas veprimtarisë si shoqëri administrimi e fondeve të pensionit vullnetar, sipas Vendimit nr. 179, datë 13.12.2011.

Ushtrimi i veprimtarisë së administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, lidhet domosdoshmërisht me licencimin e depozitarit. Për këtë arsye, në mbështetje të marrëveshjes së lidhur mes shoqërisë “Raiffeisen Invest-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a. dhe shoqërisë “First Investment Bank-Albania” sh.a., Bordi i AMF-së

### LICENCAT QË LESHON AUTORITETI

- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri sigurimi;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri risigurimi;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si degë e shoqërisë së huaj të sigurimit;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si agjent në sigurime;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri agjentësh në sigurime;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si broker në sigurime;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri brokerimi në sigurime;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si vlerësues dëmsh në sigurime;
- Autorizim për ushtrimin e veprimtarisë si Aktuar i Autorizuar;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si konsulent në sigurime;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri administruese;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si depozitar;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si agjent i fondit të pensionit;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri agjentësh të fondit të pensionit;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si degë e shoqërisë administruese;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri investimi kolektive me ofertë publike;
- Licencë për ushtrim veprimtarie si shoqëri brokerimi në tituj;
- Licencë për ushtrim veprimtarie si broker në tituj/komisioner burse;
- Licencë për ushtrim veprimtarie si këshilltar investimesh;
- Autorizim për ushtrimin e veprimtarisë si kujdestar i autorizuar;
- Licencë për ushtrim veprimtarie si bursë titujsh;
- Licencë për ushtrim veprimtarie si regjistrar.

miratoi me Vendimin nr. 175, datë 13.12.2011 licencimin e shoqërisë “First Investment Bank – Albania” sh.a. për të vepruar si Depozitar i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive. Në mbledhjen Bordit të datës 13.12.2011 u miratua, gjithashtu, Fondi i investimit “Raiffeisen PRESTIGJ”, i cili do të administrohet nga shoqëria “Raiffeisen Invest - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive”. Fondi i investimit “Raiffeisen PRESTIGJ” synon të ketë një portofol, kryesisht, në letrat me vlerë të emtuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me maturitet deri në një vit.

### **Miratimi i ofertës së parë private**

Në mbledhjen e dhjetorit 2011, Bordi i AMF-së miratoi prospektin e paraqitur nga emetuesi, shoqëria “Banka Credins” sh.a., për emetim obligacionesh me ofertë private. Miratimi i këtij emetimi u bë në mbështetje të Ligjit nr. 9879 datë 21.2.2008 “Për titujt” dhe Ligjit nr. 10158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore”. Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për obligacionet, miratimi i prospektit të shoqërisë “Banka Credins” shënoi emetimin e parë të obligacioneve nga një shoqëri aksionare.

### **Aktiviteti licencues në sigurime**

Në fushën e sigurimeve, viti 2011 shënoi miratimin e licencës paraprake të një shoqërie të re sigurimi. Ky ishte një tregues i zhvillimit të tregut, pasi që prej vitit 2004 numri i shoqërive të sigurimit, që operojnë në tregun shqiptar të sigurimeve, kishte mbetur i pandryshuar. Futja e shoqërisë së re në treg mendohet se do të ketë efekte pozitive në drejtim të përmirësimit të shumëllojshmërisë së produkteve dhe cilësisë së tyre. Përfundimi me sukses i fazës së parë të licencimit nga shoqëria e re e sigurimit “ANSIG” sh.a., do të pasohet nga plotësimi i kërkesave ligjore që i takojnë fazës së dytë dhe që do të shënojnë licencimin e saj si operatori më i ri i tregut të sigurimeve. Aktiviteti i shoqërisë “ANSIG” sh.a. do të konsistojë në klasat e Jo-Jetës.

Gjithashtu, gjatë vitit 2011, aktiviteti licencues i AMF-së ka vazhduar në drejtim të:

- licencimit të ndërmjetësve në sigurime: broker dhe agjentë;
- licencimit të vlerësuesve të dëmeve në sigurime;
- autorizimit të aktuarëve në sigurime;
- miratimit të pjesëmarrjeve influencuese, veçanërisht nga kapitali i huaj;
- miratimit të ndryshimeve statutore të shoqërive të sigurimit, që lidhen me ndryshimin e kapitalit, strukturës aksionare, apo neneve të ndryshme të statutit;
- miratimit të organeve drejtuese të shoqërive të sigurimit.

### **Broker në sigurime**

Veprimtaria e brokerimit në sigurime, si veprimtari që filloi për herë të parë në tregun shqiptar të sigurimeve në 2008, pati një tkurrje gjatë vitit 2011, duke bërë që numri i



shoqërive të brokerimit të reduktohej nga 8 në 6. Kështu, në pjesën e parë të vitit 2011, si pasojë e kërkesës së vetë shoqërive të brokerimit me vendim të Bordit iu tërhoq licenca shoqërive të brokerimit “First Broker” sh.a. dhe “LandesBroker” sh.a.

### Agjentë në sigurime

Shitja e policave të sigurimit nga shoqëritë e sigurimit realizohet nëpërmjet punonjësve shitës apo agjenteve të licencuar. AMF ka siguruar informacionin e plotë mbi çdo punonjës shitës, si dhe ka kërkuar plotësimin e kriterëve nga çdo subjekt që kërkon të licencohet si agjent shitës në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit.

Gjatë vitit 2011, nga AMF u licencuan 162 agjentë nga të cilët 109 të licencuar për herë të parë, ndërsa 53 agjentë rinovuan licencën e agjentit të marrë 3-vjet më parë.

Pjesa më e madhe e agjentëve të licencuar dhe rilicencuar gjatë vitit 2011 i takon shoqërisë “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a., ndërsa 9 agjentë janë licencuar për llogari të shoqërisë “Insig” sh.a. Ndërkohë, shoqëritë e tjera të sigurimit kanë preferuar të shesin policat e tyre nëpërmjet punonjësve të shoqërisë.

**Tabelë 3: Të dhëna mbi agjentë të licencuar**

<i>Emërtimi</i>	<i>Persona Juridike</i>	<i>Persona Fizike</i>
Agjentë të licencuar në fund te vitit 2010	8	162
Agjentë të rilicencuar në vitin 2011	-	53
Agjentë të rinj të licencuar në vitin 2011	-	109
Përfunduar afati i licencës në vitin 2011	4	87
<b>Gjithsej të licencuar në fund të vitit 2011</b>	<b>4</b>	<b>237</b>

### Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Vlerësimi i dëmeve nga shoqëritë e sigurimit me vlerësues të licencuar është një proces që ka filluar që prej vitit 2008. Edhe gjatë vitit 2011 ky proces vazhdoi dhe u shoqërua me licencimin e 7 vlerësuesve të tjerë, duke e çuar në 61 numrin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime.

Tabela më poshtë pasqyron të dhënat mbi vlerësuesit e licencuar të ndarë sipas llojit të licencës dhe sipas statusit të tyre.

**Tabelë 4: Të dhëna mbi vlerësuesit e licencuar**

Vlerësues dëmsh në sigurime		Në fund të vitit 2010	Licencime të reja 2011	Tërheqje licence 2011	Gjithsej 2011
1) Sipas Statusit të vlerësuesit	I pavarur	20	3	6	17
	I punësuar	34	4	-	38
2) Sipas Llojit të licencës	Për dëme materiale	3	1	-	4
	Për dëme shëndetësore	7	2	4	5
	Për dëme materiale dhe shëndetësore	44	4	2	46
<b>Gjithsej vlerësues të licencuar</b>		<b>54</b>	<b>7</b>	<b>6</b>	<b>55</b>

#### Aktuar

“Aktuari është përgjegjës për llogaritjen e primeve, provigjoneve teknike, dividendëve dhe tabelave të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë”.

#### Aktuar në sigurime

Roli i Aktuarit në shoqërinë e sigurimit është thelbësor në hartimin e raporteve aktuariale, llogaritjen e provigjoneve të sigurimeve dhe llogaritjen e marzhit të aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit. Në tetor të vitit 2011, AMF autorizoi 13 aktuarët e parë në sigurime. Autorizimi i aktuarëve u bë pas përfundimit të trajnimit Aktuarial në Programin e Certifikuar, prej 16 modulesh të Aktuaristikës organizuar nga FSVC, Fakulteti dhe Instituti i Aktuarëve, Mbretëria e Bashkuar dhe shoqata e Aktuarëve të Shqipërisë me mbështetjen e USAID-it dhe AMF-së.

#### Testi profesional për profesionet në fushën e sigurimeve

Aktet nënligjore mbi përcaktimin e kriterëve të licencimit të profesioneve në fushën e sigurimeve, si profesioni i brokerit në sigurime, profesioni i vlerësuesit të dëmeve, apo profesioni i aktuarit, kanë përcaktuar si kusht licencimi edhe kalimin me sukses të testimit për njohuritë në fushën përkatëse.

Gjatë vitit 2011, Autoriteti ka organizuar rregullisht testime në përputhje me kërkesat e paraqitura nga aplikantët të ndryshëm për t'u pajisur me licenca përkatëse. Qëllimi i organizimit të testeve ka qenë vënia e theksit tek profesionalizmi i aplikantëve që kërkojnë të licencohen, me synimin kryerjen e shërbimeve financiare nga profesionistë që njohin legjislacionin dhe fushën e aktivitetit ku do të operojnë. Në përbërje të komisioneve të testimit është synuar të jenë përfaqësues me reputacion dhe përvojë si nga rrethi akademik, ashtu edhe nga tregu.

#### Prania e kapitalit të huaj në shoqëritë e sigurimit

Gjatë vitit 2011, në tregun shqiptar të sigurimeve vazhdoi interesi për blerjen e aksioneve nga shoqëri të huaja financiare. Kështu, në muajin shtator, Autoriteti miratoi pjesëmarrjen influencuese të aksionarit “Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe” në masën 75% + 1 aksion në shoqërinë e sigurimit “Intersig” sh.a.






Rritja e pranisë së kapitalit të huaj në tregun shqiptar të sigurimeve dëshmon se ky treg përmban potenciale të mëdha zhvillimi dhe është tërheqës për investitorët e huaj. Nga ana tjetër, prania e aksionerëve të huaj, si shoqëri sigurimi me emër dhe me shumë përvojë në tregun e sigurimeve, ka stimuluar zhvillime pozitive të tregut, kryesisht në rritjen e produkteve vullnetare të sigurimit.

Gjatë vitit 2011, shoqëria sllovene e sigurimeve “Zavarovalnica Triglav” d.d., e cila zotëronte 9.9% të kapitalit aksionar të shoqëria e sigurimit “Albsig” sh.a., rishiti aksionet tek aksionarët ekzistues.

Për sa më sipër, për vitin 2011, numri i aksionarëve të huaj që zotërojnë aksione në shoqëritë shqiptare të sigurimit është 3 dhe aktualisht në tregun shqiptar të sigurimeve operojnë:

- “Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe” me seli kryesore në Vienë, Austri;
- “Uniqa International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH” me seli kryesore në Vienë, Austri;
- Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve.

### Struktura e kapitalit sipas vendit të origjinës – 2011



### Qeverisja e shoqërive të sigurimit

Në rritjen e rolit mbi qeverisjen e shoqërive të sigurimit, AMF ka respektuar kriteret për të zgjedhurit në këshillat mbikëqyrës, në postet drejtuese apo komitetet e kontrollit. Në të njëjtën kohë, AMF ka tentuar të nxisë rritjen e integritetit, profesionalizmit, eksperiencës dhe kualifikimit, brenda kuadrit ekzistues rregullativ.

Gjatë vitit 2011, Autoriteti ka miratuar ndryshime apo riemërime në përbërjen e këshillave mbikëqyrës në gjashtë shoqëri sigurimi, si dhe ka miratuar emërimet në organet drejtuese në tri shoqëri sigurimi.

Skema më poshtë paraqet strukturën aktuale të drejtimit të shoqërive të sigurimit.



**Tabelë 5: Qeverisja e shoqërive të sigurimit – Statistika**


Qeverisja e shoqërive të sigurimit - statistika	2007	2008	2009	2010	2011
Nr. mesatar i aksionarëve	6.0	4.5	4.2	4.4	4.2
Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës	5.0	3.6	3.4	3.6	4.0
Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që nuk janë aksionarë	2.0	2.8	2.7	3.1	3.5
Nr. i Drejtorëve Ekzekutivë me pjesëmarrje influencuese mbi 10%	3.0	3.0	2.0	2.0	3.0

**Tabelë 6: Numri i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese - 2011**

Emërtimi	Numri
Shoqëri sigurimi	10
Aksionarë gjithsej	42
Me pjesëmarrje zotëruese si më poshtë:	
nën 10%	23
mbi 10% nën 20%	5
mbi 20% nën 33 %	3
mbi 33% nën 50%	1
mbi 50%	10
Aksionarë të huaj	3
Aksionarë vendas	39
Aksionarë si individë	33
Aksionarë si shoqëri	8
Aksionarë shteti	1



### Të dhëna për aksionarët – 2011 (numër)



### Miratime të ndryshimeve statutore të shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2011 në AMF janë paraqitur dhe miratuar një numër kërkesash për ndryshime statutore, të cilat kanë konsistuar në:

- ndryshimin e statutit si rezultat i ndryshimit të madhësisë së kapitalit aksionar për 4 shoqëri sigurimi;
- ndryshimin e statutit si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare për 3 shoqëri sigurimi;
- statut i ri apo ndryshim të neneve të statutit për 6 shoqëri sigurimi.

**Tabelë 7: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore**

Arsyeja e Ndryshimit të Statutit	Numri i Shoqërive			
	2008	2009	2010	2011
Statut i ri	2	2	2	6
Rritje kapitali	9	4	2	4
Ndryshim i strukturës aksionare	2	2	5	3

### Aktiviteti licencues në tregun e letrave me vlerë

Gjatë vitit 2011, aktiviteti licencues i Autoritetit në tregun e letrave me vlerë është fokusuar në këto drejtime:

- *Licencim aktivitet brokerimi.* Në muajin prill, Bordi i AMF-së licencoi shoqërinë “Aksionar International Securities Brokerage” sh.a. për të ushtruar veprimtari për shitjen dhe blerjen e titujve me porosi të klientit në tregun e licencuar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Njëkohësisht, u licencua Z. Mark Crawford si broker fizik për llogari të kësaj shoqërie.

- *Autorizim veprimtarie kujdestarie në letrat me vlerë.* Gjatë vitit 2011, Autoriteti me vendimin Nr. 183, datë 13.12.2011, autorizoi shoqërinë, “Banka Societe Generale Albania” sh.a. për të vepruar si kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë. Gjithashtu, me vendimin Nr. 181, datë 13.12.2011, autorizoi shoqërinë “Banka Credins” sh.a. për të vepruar si kujdestar i obligacioneve të shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore.

Pjesa më aktive e tregut të letrave me vlerë është tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë shqiptare. Në këtë treg operojnë kryesisht bankat e licencuara nga Autoriteti për të kryer këtë veprimtari. Bankat e licencuara janë: “Raiffeisen Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a., “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a., “Alfa Bank Albania” sh.a., “Banka Credins” sh.a., “Tirana Bank” sh.a. dhe “First Investment Bank” sh.a.

**Tabela 8: Numri i subjekteve të licencuara që operojnë në tregun e letrave me vlerë**

<i>Subjekte të licencuara</i>	<i>2006</i>	<i>2007</i>	<i>2008</i>	<i>2009</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>
Shoqëri komisionere të letrave me vlerë	9	11	12	11	12	13
Broker fizik në shoqëri komisionere	12	14	15	14	16	17
Kujdestarë të letrave me vlerë të Qeverisë së R.Sh.	0	0	0	0	7	8
Regjistruar të letrave me vlerë	6	6	6	6	1	1
Tregje të organizuar të letrave me vlerë	1	1	1	1	1	1

## **Aktiviteti licencues në tregun e pensioneve vullnetare**

Organizimi dhe funksionimi i pensioneve vullnetare, sipas ligjit të ri, përfaqëson një skemë të re në administrimin e pensioneve vullnetare. Në këtë skemë organizimi, një rëndësi e madhe i kushtohet veçanërisht profesionalizmit të drejtuesve të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit vullnetar, duke gjykuar për veçoritë që paraqet administrimi i këtyre fondeve.

Gjatë vitit 2011, Bordi i AMF-së miratoi dhënien e licencave të reja për të vepruar si shoqëri e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar, për mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensioneve, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit. Kështu, në muajin mars u licencua “Shoqëria administruese e fondeve të pensionit vullnetar Sigal-Life” sh.a. dhe në muajin nëntor “Shoqëria administruese e fondeve të pensionit SiCRED” sh.a.

**“Shoqëri administruese e fondit të pensionit vullnetar”**, është një shoqëri aksionare, e krijuar në përputhje me ligjin e shoqërive tregtare dhe e licencuar nga Autoriteti, për të administruar një ose disa fonde pensionesh.



Njëkohësisht me licencimin e shoqërive administruuese, Bordi i AMF-së miratoi dhe fondet përkatëse të pensione që do të jenë nën administrimin e shoqërive administruuese përkatëse. Pikërisht Fondi i pensioneve SIGAL nën administrimin e shoqërisë administruuese SIGAL LIFE dhe Fondi i pensionit SiCRED i cili do të jetë nën administrimin e shoqërisë administruuese SiCRED sh.a.

Kryerja e veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit vullnetar lidhet domosdoshmërisht me ekzistencën e depozitarit të licencuar nga Autoriteti. Për këtë arsye, "Shoqëria administruuese e fondeve të pensionit vullnetar Sigal-Life" sh.a. nënshkroi kontratën për shërbime depozitari me shoqërinë "Tirana Bank" sh.a., e cila mban licencë depozitari për fondet e pensioneve vullnetare. Ndërsa, "Shoqëria administruuese e fondeve të pensionit SiCRED" sh.a. lidhi kontratë për shërbime depozitari me shoqërinë "Banka Societe General Albania" sh.a., e cila u licencua për këtë veprimtari nga Bordi i AMF-së në dhjetor 2011.

Funksionet kryesore të shoqërisë administruuese janë mbledhja dhe investimi i fondeve të pensioneve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe në përputhje me parimin e shpërndarjes së riskut (diversifikim), për ofrimin e përfitimeve të pensionit për personat që bashkohen në fondin e pensionit. Shoqëria administruuese, gjithashtu, mund të ketë edhe funksionin e kryerjes së pagesave të pensionit.

**"Depozitar"** është banka e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit, si dhe e miratuar nga AMF, për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e fondit të pensionit.

Funksionet e depozitarit janë:

- llogarit vlerën neto të asetëve të fondit të pensionit;
- kontrollon se si administron asetet e fondit të pensionit, shoqëria administruuese;
- siguron që t'i kthehet fondit të pensioneve çdo përfitim brenda afateve kohore të përcaktuara;
- siguron që të gjitha të ardhurat e fondit të pensionit të shpërndahen në përputhje me kontratën e fondit të pensionit dhe me legjisllacionin në fuqi.

## 2.3 Aktiviteti mbikëqyrës

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi dhe në respektim të funksioneve të veta, Autoriteti, gjatë vitit 2011, ka analizuar dhe mbikëqyrur veprimtarinë e sektorit të sigurimeve. Kështu, është shqyrtuar kryesisht pozicioni financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së tregut të sigurimeve dhe të shoqërive të sigurimit në veçanti. Si përparësi në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes kanë qenë përmirësimi i procesit të mbikëqyrjes së këtij tregu dhe ruajtja e interesave të të siguruarve.

### Për një mbikëqyrje më efektive

Me qëllim forcimin e metodologjisë së mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, Autoriteti filloi në vitin 2008 projektin "Drejt një mbikëqyrje efektive" financuar nga First Initiative me asistencën e Bankës Botërore. Me përfundimin e këtij projekti, u prezantuan Manuali i Mbikëqyrjes dhe Projektligji i Sigurimeve, të cilat së bashku me sistemin e raportimit AMF In-Reg përbëjnë shtyllat kryesore të metodologjisë së re.

Një sistem mbikëqyrjeje me fokus riskun, ka në thelb matjen e risqeve në mënyrën më objektive të mundshme, duke përdorur edhe tregues financiarë apo duke zbatuar norma për

matjen e efikasitetit të Këshillit Mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë. Qëllimi është hartimi i një profili risku, i cili përfaqëson vlerësimin nga ana e autoritetit mbikëqyrës për shoqërinë në lidhje me fushat e risqeve specifike të shoqërisë, brenda kontekstit të sektorit të sigurimeve. Përveç se është një sistem që identifikon dhe mat risqet, pjesë e këtij sistemi janë dhe fazat e ndërhyrjes nga ana e autoritetit mbikëqyrës, për nivele të ndryshme të riskut, ndërhyrje e cila shpeshtohet dhe forcohet me rritjen e nivelit të riskut në një shoqëri sigurimi. Projekt ligji mbi sigurimet synon krijimin e hapësirave të nevojshme ligjore për zbatimin e kësaj metodologjie të re. Nëpërmjet ngritjes së sistemit të bazuar në raportimin financiar teknik dhe statistikor, drejtpërdrejtë në faqen zyrtare të AMF-së në Internet, bëhet e mundur rritja e cilësisë së raportimit, si dhe mbështetja e strategjisë së ndërhyrjes në kohë për parandalimin e problemeve.

Zbatimi i metodologjisë së re të mbikëqyrjes bëhet i mundur pas mbështetjes me legjislacionin përkatës duke ndjekur një plan strategjik veprimi, i cili do të identifikojë hapat për zbatimin e metodologjisë, të shtrira dhe në kohë. Autoriteti ka miratuar dokumentin e planit strategjik të zbatimit që duhet të ndiqet në vitet në vijim, me qëllim që metodologjia e mbikëqyrjes me fokus riskun të vihet në zbatim dhe të realizojë me sukses objektivat e saj.

### **Analiza Financiare e Tregut të Sigurimeve (off-site)**

Mbikëqyrja e tregut të sigurimeve përfshin raportimin e saktë dhe në kohë të pasqyrave teknike e financiare, analizën e informacionit të marrë mbi aktivitetin e shoqërive të sigurimit, si dhe inspektimin në vend të këtyre shoqërive.

Analiza e thelluar financiare është kryer përmes vlerësimit të pozicionit financiar, rezultateve teknike dhe financiare të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit, mbështetur në të dhënat e raportimit periodik të këtyre shoqërive në Autoritet, informacioneve shtesë të depozituara nga këto shoqëri ose institucione të tjera, si dhe mbi gjetjet e inspektimit në vend.

Një rëndësi e veçantë i kushtohet kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe provigjoneve teknike. Autoriteti vlerëson nëse provigjonet teknike, të cilat përfaqësojnë detyrimet ndaj të siguruarve, janë të mjaftueshme dhe mbulohen jo më pak se vlera bruto e tyre me aktive të përshtatshme në çdo kohë. Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të kenë mjaftueshmëri kapitali në çdo kohë. Mos përmbushja e kërkesave për minimumin e kapitalit të kërkuar, përbën shkelje të rregullave të menaxhimit të riskut. Nëse Autoriteti vë re ndonjë parregullsi në përmbushjen e këtyre treguesve, ndërmerri masat e duhura.

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi fondin e garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Aktualisht shoqëritë e sigurimit zotërojnë fondin e garancisë të investuar në “depozita qëllimore” me afat 1-vjeçar pranë bankave të nivelit të dytë dhe bono thesari, sipas kërkesave të ligjit. Totali i Fondit të Garancisë për tregun është në vlerën 4.315 mln. lekë. Treguesi i Kapitalit që disponon tregu në raport me Fondin e Garancisë është në masën 129.38%.



**Tabelë 9: Struktura dhe dinamika e Aktivit dhe Pasivit të tregut të sigurimeve**

Emërtimi	31.12.2009	31.12.2010	31.12.2011
<i>Struktura (në %)</i>			
Depozita	49.86	50.84	45.90
Toka dhe ndërtime	9.76	10.23	9.32
Aksione dhe pjesëmarrje	8.26	9.31	13.65
Bono thesari	3.01	4.91	4.89
Debitorë	8.41	8.45	8.66
Aktive të tjera	20.69	16.27	17.58
<b>Totali i Aktivit</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>
Provigjonet teknike bruto	38.39	34.21	39.44
Detyrime të tjera	8.95	8.06	7.79
Kapitalet e veta	52.66	57.73	52.77
<b>Totali i Pasivit</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>
<i>Dinamika (në %) viti i mëparshëm = 100</i>			
Depozita	-	113.35	96.94
Toka dhe ndërtime	-	116.45	97.82
Aksione dhe pjesëmarrje	-	125.36	157.41
Bono thesari	-	181.14	107.04
Debitorë	-	111.61	110.03
Aktive të tjera	-	87.38	116.07
<b>Totali i Aktivit</b>	<b>-</b>	<b>111.16</b>	<b>107.37</b>
Provigjonet teknike bruto	-	99.07	123.76
Detyrime të tjera	-	100.15	103.76
Kapitalet e veta	-	121.85	98.16
<b>Totali i Pasivit</b>	<b>-</b>	<b>111.16</b>	<b>107.37</b>

Pasqyrat e bilancit në tabelën e mësipërme përfshijnë shoqëritë e sigurimeve të Jo-Jetës dhe Jetës. Raportimi i pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit bëhet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe në mbështetje të bazës rregullative të Autoritetit.

Gjatë analizës së gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit, për të dhënat e 31.12.2011 u vu re se totali i aktivitetit të tregut të sigurimeve sipas pasqyrave financiare arriti vlerën 19.3 mld. lekë. Krahasuar me 31.12.2010, totali i aktivitetit u rrit me 1.32 mld. lekë. Investimet në depozita në banka zënë pjesën më të madhe të aktivitetit me 45.90%, investimet në toka dhe ndërtesa përbëjnë 9.32% të totalit të aktivitetit. Vihet re rritje kryesisht në zërin Aksione dhe Interesa Pjesëmarrëse, Aktive të tjera, si dhe në zërin Debitorë. Në pasivin e pasqyrës së Bilancit të 31.12.2011 vihet re rritje e zërit Provigjone Teknike Bruto në masën 23.76% ose në vlerën 1.46 mld. lekë në krahasim me 31.12.2010.

**Tabelë 10: Disa Karakteristika mbi Tregun e Sigurimeve**

(mln lekë)

<i>Periudha Ushtrimore</i>	<i>2007</i>	<i>2008</i>	<i>2009</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>13,360</b>	<b>15,525</b>	<b>16,227</b>	<b>18,039</b>	<b>19,368</b>
Jeta	1,401	1,841	2,919	2,473	2,884
Jo-Jeta	11,959	13,684	13,308	15,566	16,484
<b>Totali i investimeve</b>	<b>9,255</b>	<b>11,182</b>	<b>10,830</b>	<b>11,855</b>	<b>12,839</b>
Jeta	1,071	1,389	2,101	1,832	1,992
Jo-Jeta	8,184	9,793	8,729	10,023	10,847
<b>Provigjonet teknike bruto</b>	<b>5,929</b>	<b>5,138</b>	<b>6,229</b>	<b>6,171</b>	<b>7,638</b>
Jeta	227	233	361	644	853
Jo-Jeta	5,702	4,905	5,868	5,527	6,785
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>6,956</b>	<b>8,832</b>	<b>8,546</b>	<b>10,413</b>	<b>10,221</b>
Jeta	1,247	1,541	1,754	1,763	1,791
Jo-Jeta	5,709	7,291	6,792	8,649	8,430
<b>Totali i kapitalit të nënshkruar</b>	<b>5,191</b>	<b>6,031</b>	<b>5,787</b>	<b>6,684</b>	<b>7,607</b>
Jeta	1,001	1,248	1,097	1,278	1,283
Jo-Jeta	4,190	4,783	4,690	5,406	6,324
<b>Totali i investimeve të huaja</b>	<b>2,378</b>	<b>2,924</b>	<b>1,985</b>	<b>3,587</b>	<b>3,472</b>
Jeta	379	460	355	347	380
Jo-Jeta	1,999	2,463	1,630	3,240	3,092
<b>Primet e shkruara bruto</b>	<b>5,948</b>	<b>7,076</b>	<b>7,877</b>	<b>8,207</b>	<b>8,215</b>
Jeta	410	515	721	848	941
Jo-Jeta	5,538	6,561	7,156	7,359	7,274
<b>Primi i fituar neto</b>	<b>4,705</b>	<b>5,543</b>	<b>6,092</b>	<b>6,680</b>	<b>6,792</b>
Jeta	357	459	469	636	819
Jo-Jeta	4,348	5,083	5,596	6,044	5,973
<b>Dëmet e paguara bruto</b>	<b>1,294</b>	<b>1,571</b>	<b>1,733</b>	<b>2,289</b>	<b>2,228</b>
Jeta	44	45	79	72	116
Jo-Jeta	1,250	1,526	1,654	2,217	2,112





## Treguesit Financiarë IRIS

Nisur nga synimi i punës së Autoritetit për ngritjen e një tregu financiar të stabilizuar dhe në kuadrin e projektit të Autoritetit në bashkëpunim me BB, me qëllim kalimin në drejtim të metodës të mbikëqyrjes me fokus riskun, gjatë vitit 2011 ka vazhduar të zbatohet sistemi i paralajmërimit të hershëm.

Kështu, në analizën e gjendjes financiare të sektorit të sigurimeve, në vlerësimin e shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, përdoren edhe treguesit e sistemit IRIS (Sistemi Informativ Rregullativ i Sigurimeve) të përshtatura për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës në Shqipëri.

Këto tregues financiarë i shërbejnë evidentimit në kohën e duhur të problemeve që mund të çojnë në përkeqësimin e një ose disa parametrave të operatorëve në treg.

**Tabelë 11: Diapazonet e vlerave të treguesve financiarë IRIS**

Raporti	31.12.2009	31.12.2010	31.12.2011	Kufiri (%)	
				MIN	MAX
Norma e rritjes së primit	9.07%	2.73%	- 1.06%	-40	40
Raporti i mbajtjes neto	82.16%	84.37%	81.61%	40	80
Raporti dëme/prime neto	36.24%	32.86%	42.97%	50	80
Raporti i shpenzimeve	70.28%	62.28%	73.98%	25	50
Raporti i kombinuar	106.52%	95.14%	116.96%	85	105
Të ardhurat nga investimet	7.14%	8.04%	7.67%	4	8
Raporti i kapitalit	51.92%	69.83%	57.00%	20	50
Raporti i provigjoneve teknike	73.52%	96.51%	66.78%	10	30
Raporti i aftësisë paguese	374.4%	439.5%	333.30%	150	300

Norma e rritjes së primeve të tregut të sigurimeve të Jo-Jetës është brenda kufijve të përcaktuar, ndonëse ka tendencë në rënie. Kështu në 2011, norma e rritjes së primeve të Jo-Jetës është -1.06%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Raporti i mbajtjes neto në tregun shqiptar të sigurimeve të Jo-Jetës është në masën 81.61%, ndërkohë që normat e përcaktuara ndërkombëtare rekomandojnë vlera midis 40 dhe 80%.


Raporti dëme/prime për tregun shqiptar të sigurimeve të Jo-Jetës ka arritur në 42.97%. Ky raport ka patur rritje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Raporti i shpenzimeve, vijon të jetë mbi nivelet e përcaktuara për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës në Shqipëri. Peshën më të madhe në strukturën e shpenzimeve e zënë

shpenzimet operative të veprimtarisë në masën 63.12% për tregun e Jo-Jetës.

Raportet financiare të mësipërme ilustrohen në tabelat e mëposhtme në mënyrë grafike për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës në 31.12.2011.

### Treguesit IRIS 2011





## Inspektime në vend (on-site) në subjektet e mbikëqyrura

Inspektimi në vend në subjektet e mbikëqyrura ka për qëllim të sigurojë që subjektet e mbikëqyrura menaxhohen dhe kontrollohen në përputhje me praktika të shëndosha biznesi dhe financiare.

Qëllimi i inspektimit, është identifikimi i devijimeve të rëndësishme nga ligjet, rregulloret dhe udhëzimet e AMF-së, si edhe identifikimi i mangësive të rëndësishme operationale dhe të kontrollit të brendshëm të subjekteve të mbikëqyrura.

Në varësi nga çështjet që do të inspektohen, inspektimi në vend mund të përfshijë një tematikë të gjerë duke u shtrirë mbi gjithë aktivitetin e subjektit, ose mund të fokusohet në problematika të veçanta, të cilat i nënshtrohen inspektimit në vend, tematik, apo me objekt të kufizuar.

### Kryerja e Inspektimit on-site mbështetet në:

- Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Zbatueshmërinë e Vendimeve të Bordit të AMF-së;
- Analizat dhe raportet e hartuara të mbikëqyrjes;
- Raportimet financiare periodike dhe vjetore të subjektit të mbikëqyrur në Autoritet;
- Raportet e shoqërisë audituese (përfshirë edhe letrën për drejtuesit);
- Raportet e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm dhe të aktuarit të autorizuar;
- Informacionin analitik (të dhëna të regjistruara në sistemin elektronik online të shitjeve dhe regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, etj);
- Informacionin nga palët e treta;
- Treguesit e mbrojtjes së të siguruarve, investitorëve dhe kontribuesve.

Objektivi kryesor i çdo inspektimi on-site është vlerësimi i aftësisë paguese aktuale dhe të pritshme të shoqërisë. Në mënyrë specifike objektivi i këtij inspektimi është të krahasojë profilin e riskut të shoqërisë, me kapacitetin e mbajtjes së tij dhe të identifikojë çdo problem që mund të influencojë në aftësinë e shoqërisë për t'ju përgjigjur detyrimeve afatgjata të policëmbajtësve.

Inspektimi në vend ushtrohet nëse Autoriteti ka sinjale për probleme financiare të subjekteve të mbikëqyrura, ndryshime të konsiderueshme në menaxhimin e subjektit, ndryshime në strukturën e subjektit (shkrirje, bashkim të tij, etj), transferim portofoli, ankesa të të siguruarve, etj.

Gjatë vitit 2011, Drejtoria e Inspektimit ka kryer 22 inspektime në vend, nga të cilat 10 inspektime të plota dhe të planifikuara, 8 inspektime tematike të planifikuara, 1 inspektim tematik i pa planifikuar dhe 3 inspektime të përbashkëta.

## Inspektime në Subjektet e Mbikëqyrura

### Inspektimi i pasqyrave financiare

Inspektimi i pasqyrave financiare konsiston në verifikimin në vend të çështjeve apo problemeve që kanë dalë gjatë analizave periodike në subjektet e mbikëqyrura si edhe nga problematika specifike që kërkojnë verifikim të mëtejshëm dhe të menjëhershëm.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të vlerësuar gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit, ushtroi inspektime të plota dhe të planifikuara, në vend në 10 shoqëritë e sigurimit (Jetë dhe Jo-Jetë). Në objektin e këtyre inspektimeve si rezultat i ndryshimit të filozofisë së mbikëqyrjes drejt asaj me fokus riskun u përfshinë edhe tematika të reja të cilat ndihmojnë në zbatimin e kësaj metodologjie të re mbikëqyrjeje me qëllim:

- Verifikimin e elementëve të pasqyrave financiare të këtyre shoqërive për vitin 2010 dhe 3 muajorin e parë të vitit 2011;
- Shqyrtimin e politikave të shoqërive të sigurimit në lidhje me efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Roli i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm në lidhje me vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit me bazën ligjore në fuqi dhe me politikat dhe procedurat e brendshme të shoqërisë;
- Njohjen me politikat dhe procedurat e shoqërive të sigurimit lidhur me marrjen në sigurim, limitet e mbajtjes së rrezikut, të specifikuara sipas llojit të produktit të marrë në sigurim;
- Njohjen me politikat dhe procedurat e shoqërive të sigurimit lidhur me vlerësimin dhe menaxhimin e dëmeve, praktikat e provigjonimit si dhe aspekte që lidhen me risigurimin;
- Njohjen me procedurat e brendshme të shoqërive të sigurimit, në lidhje me kërkesat e parashtruara në rregulloren e AMF mbi funksionimin e sistemit të raportimit AMF In-Reg, në drejtim të:
  - Përcaktimit të hierarkisë së përdorimit të sistemit AMF In-Reg nga përdoruesit individualë;
  - Kualifikimit të personelit të caktuar nga shoqëria e sigurimit për përdorimin e sistemit;
  - Hartimit të rregullave të brendshme për funksionimin e sistemit të raportimit AMF In-Reg.
- Analizën e përgjegjësive të kontraktuara nga shoqëritë e sigurimit për vitin 2010, risigurimet, pagesat e risiguruesve, si edhe reflektimi në llogaritjet e rezervës së risiguruesve.

Pjesë e rëndësishme e inspektimit të shoqërive të sigurimit ka qenë edhe siguria e sistemeve të informacionit. Ky informacion u përqendrua në disa drejtime kryesore:

- Dokumentacioni në lidhje me teknologjinë e informacionit;
- Dokumentacioni mbi punonjësit e përfshirë në menaxhimin e sistemeve informatike të shoqërive;
- Plani i investimeve të shoqërive në teknologjinë e informacionit: sisteme, lidhje rrjeti dhe punonjës.

Nga inspektimet rezultoi se përgjithësisht tregu i sigurimeve ka vepruar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e rregullativ mbikëqyrës. Megjithatë në raportet e inspektimit



jepen gjetje të cilat lidhen me:

- administrimin e rrezikut nga shoqëritë e sigurimit;
- përgjegjësitë e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm të shoqërisë së sigurimit përsa i përket verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore në fuqi, parregullsive në drejtim të respektimit të pavarësisë së këtij Komiteti nga Këshilli Mbikëqyrës, rregullave të funksionimit dhe të ushtrimit të kontrollit të brendshëm si edhe të cilësisë së raporteve të kontrollit të brendshëm.
- zbatimin e Ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- përmirësimin e politikave, procedurave dhe standardeve teknologjike që lidhen me sigurinë e sistemeve të informacionit.

Për të komunikuar rezultatet e inspektimit të kryer, Autoriteti i paraqet drejtuesve të subjektit të mbikëqyrur raportin përfundimtar të inspektimit në formën e Letrës për Drejtuesit. Letra për Drejtuesit përmban gjetjet e konstatuara dhe efektet e tyre në aktivitetin e shoqërisë, citon shkeljet e ligjit apo të rregulloreve të AMF-së si dhe të çdo praktike tjetër jo “të shëndoshë”, jep rekomandimet përkatëse për gjetjet e konstatuara duke iu referuar edhe afateve kohore brenda të cilave subjektet e mbikëqyrura duhet t’i përgjigjen rregullatorit.

Konkluzionet dhe rekomandimet që rezultuan nga inspektimet e kryera, shërbyen si bazë për analizën e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit për vitin 2010 dhe 3-mujorin e parë të vitit 2011.

### **Inspektime të përbashkëta**

Në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave më të mira në ushtrimin e mbikëqyrjes, një bashkëpunim i suksesshëm ka rezultuar edhe me Institucionet Mbikëqyrëse homologe në rajon.

Në mars 2011, AMF me kërkesë të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS), Maqedoni, mori pjesë në një inspektim të përbashkët të organizuar nga AMS në një nga shoqëritë e sigurimit që operojnë në Maqedoni. Ky inspektim i shërbeu kryesisht shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave të vendeve respektive, si edhe forcimit të bashkëpunimit reciprok midis dy rregullatorëve në fushën e sigurimeve.

Gjatë 2011, AMF, në kuadër të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, ka kryer inspektim të përbashkët tematik në bankat e nivelit të dytë me qëllim verifikimin në vend:

- të kontratave të garancisë dhe të kreditit të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit, për të evidentuar përfituesin dhe kushtet e kontratave, me qëllim përcaktimin e klasës së sigurimit;
- të të gjitha vlerave monetare të shoqërive të sigurimit, të vendosura në bankë për t’u ruajtur gjatë vitit, me destinacion qëllimor.

Në shtator 2011, në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet Institucioneve, AMF ka kryer një inspektim të përbashkët me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit bazuar në "Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", datë 31.03.2011, nënshkruar midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

Ky bashkëpunim mundëson kontrollin e zbatimit të legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve motorike që lëvizin në territorin e Republikës së Shqipërisë me kontrata sigurimi të vlefshme, zvogëlimin e numrit të mjeteve të transportit të pasiguruara, kontrollet e përbashkëta dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të qarkullimit të mjeteve motorike.

Inspektimi u përqendrua në evidentimin dhe verifikimin në vend në dy drejtime kryesore:

- të mjeteve motorike pa polica të sigurimit të detyrueshëm motorik;
- të mjeteve motorike me polica të parregullta të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe të paraportuara në kohë reale në AMF në regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe për të kontribuar në rritjen e sigurisë rrugore kombëtare, rezultatet e këtij inspektimi iu komunikuan edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si institucioni përgjegjës për marrjen e masave administrative për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit. Këto inspektime të përbashkëta me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit do të vijojnë të kryhen rregullisht edhe në ardhmen bazuar në plan veprimin për zbatimin e Urdhrit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe AMF-së.

### **Inspektime të tjera në vend**

Në vitin 2011, janë ushtruar 8 inspektime tematike të planifikuara në shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës lidhur me dëmet e paguara dhe të mbetura pezull për vitin 2010 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2011. Këto inspektime u përqendruan në drejtimet e mëposhtme:

- Verifikimi i procedurave të ndjekura nga shoqëritë e sigurimit në procesin e trajtimit të dëmeve që rrjedhin nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik, vlerësimit dhe pagesës së dëmeve sipas kërkesave të Ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe Rregullores Nr. 53 e AMF "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit";
- Verifikimi i procedurave të ndjekura për praktikatat e dëmeve të refuzuara, duke shqyrtuar shkaqet e paraqitura nga shoqëria për refuzimin e kërkesave për dëmshpërblim, trajtimin të dëmeve në proces gjyqësor dhe të dëmeve të mbetura pezull;



- Verifikimi i raportimeve të shoqërive të sigurimit në regjistrin elektronik të të dhënave të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike dhe krahasimi i këtyre të dhënave me raportimin e shoqërive në bazën e të dhënave të regjistrit (aktuarial) të dëmeve;
- Verifikimi i trajtimit të ankesave të policëmbajtësve në shoqëri.

Një rol të rëndësishëm në trajtimin me korrektësi dhe të paanshëm të konsumatorit luajnë hartimi dhe miratimi i Ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe Rregullores nr. 53 e AMF, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.

AMF në vazhdimësi gjatë vitit 2011, në zbatim të kërkesave të rregullores “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik”, miratuar me Vendim Bordi të AMF, nr. 3 datë 03.10.2007, e ndryshuar, ka ushtruar edhe inspektime të tjera tematike në shoqëritë e sigurimit. Këto inspektime janë përqendruar kryesisht në verifikimin në vend të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik të shitura dhe të raportuara në Autoritet.

Mbështetur në gjetjet, problematikën apo mangësitë e konstatuara nga këto inspektime, Bordi i AMF-së, mori vendime që kishin të bënin me marrjen e masave apo vendosjen e sanksioneve ndaj shoqërive të sigurimit, si dhe me dhënien e rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit.

### **Masat korrigjuese dhe administrative**

Qëllimi dhe objektivi i Autoritetit është që nëpërmjet marrjes së masave administrative parandaluese dhe korrigjuese të sigurohet parandalimi i fenomeneve negative që shfaqen gjatë veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura, të mbrohet konsumatori dhe të forcohet besimi i tij, për rolin e AMF-së.

Autoriteti vë në dukje përmirësime të konsiderueshme në lidhje me një qasje më largpamëse të masave parandaluese dhe korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura. Masat mbikëqyrëse, korrigjuese e sanksionuese janë vendosur nga Autoriteti në mënyrë të paanshme, transparente duke reflektuar konkluzionet në ushtrimin e mbikëqyrjes.

Marrja e masave bazohet në inspektimet në vend, kontrollin mbi dokumente, hetim të informacionit, apo ankesave të depozituara. Autoriteti ka punuar me kujdes në drejtim të njohjes, identifikimit të problematikave duke ndërmarrë masa përkatëse me qëllim zbatimin e tyre në praktikën e përditshme. Konstatimet e gjetura përfshijnë shkelje të dispozitave të ligjit në lidhje me qëndrueshmërinë financiare, rregullat e menaxhimit të riskut, raportimet e sakta dhe në kohë, organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, trajtimi i dëmeve, etj.

Masat e vendosura ndaj subjekteve të mbikëqyrura kanë ndikuar në një përmirësim të pozitave financiare të disa subjekteve si dhe kanë ndikuar në zvogëlimin e riskut.

Autoriteti ka proceduar në përshkallëzim të masave parandaluese dhe korigjuese në rastet kur situatat janë përkeqësuar ose kërkesat dhe rekomandimet e tij nuk janë përmbushur në masën e kërkuar. Gjithashtu, nëse është gjykuar e nevojshme, janë kërkuar plane efektive për parandalimin e problemeve. Këto plane kanë përfshirë hapa të caktuar për zgjidhjen e problematikave të konstatuara brenda një afati të caktuar kohor.

### **Parashikimet ligjore për masat administrative**

Ligji nr. 9267 datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime” parashikon masa administrative si më poshtë:

- Urdhër për eliminim shkeljesh;
- Masa korigjuese;
- Plan financiar;
- Gjobë subjektiv;
- Gjobë personit përgjegjës;
- Tërheqje licence;
- Administrim i përkohshëm;
- Likuidim.

Ligji nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, parashikon një sërë masash administrative që lidhen me veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm të shoqërive të sigurimit.

Masat administrative parashikojnë sanksione ndaj shoqërive të sigurimit, personave përgjegjës të shoqërive të sigurimit, drejtorit ekzekutiv të Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS) dhe personave përgjegjës të BSHS.

Ligji nr. 10076, datë 12.02.2009, parashikon masa administrative të qarta në lidhje me procedurat dhe afatet e dëmshpërblimit (neni 12). Për shkelje të këtij neni ligji parashikon për shoqëritë e sigurimi:

- Shpalljen publike, me shpenzimet e veta (të shoqërisë) të të dhënave për praktika të gabuara;
- Tërheqjen e miratimit për anëtarët e organeve drejtuese;
- Tërheqjen, përkohësisht ose përfundimisht, të licencës për kryerjen e veprimtarisë përkatëse.

Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” parashikon sanksione administrative, për çdo person, ortak apo aksionar të personit juridik, që pengon Autoritetin, strukturat apo nëpunësit e tij për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara nga legjislati në fuqi.





Në zbatim të legjislacionit në fushën e sigurimeve, me qëllim përmbushjen e objektivave të tij rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe me qëllim sigurimin e stabilitetit të tregjeve financiare jo-bankare dhe mbrojtjen e konsumatorit, Autoriteti ka ndërhyrë me marrjen e masave administrative të cilat kanë synuar parandalimin apo ndërprerjen e pasojave të shkeljeve të ligjit, si dhe korrigjimin e shkeljeve.

**Tabela 12: Masa administrative të marra nga AMF ndaj shoqërive të sigurimit në vitin 2011 \***

Masa korrigjuese	9
Urdhër për eliminim shkeljeje	11
Sanksion me gjobë	1
Plan masash financiare	1
Paralajmërim për tërheqje licence	3
Tërheqje licence agjenti në sigurime	1
Tërheqje licence vlerësues dëmsh në sigurime	6

\* Masat janë marrë nga konstatimet e:

- Analizave financiare të vitit 2010, dhe analizave periodike të vitit 2011;
- Inspektimeve pranë shoqërive të sigurimit, ndërmjetësve dhe vlerësuesve të dëmeve;
- Detyrimit të shoqërive të sigurimit për financimin e Fondit të Kompensimit.

Autoriteti në mënyrë të vazhdueshme dhe transparente ka ndjekur zbatimin e masave administrative sipas afateve të përcaktuara në vendimet e tij, duke analizuar në mënyrë të hollësishme raportet e depozituara, me qëllim eliminimin e shkeljeve për arritjen e qëndrueshmërisë financiare të subjekteve të mbikëqyrura.

**Tabela 13: Proceset gjyqësore lidhur me masat administrative të marra nga AMF, deri më 31.12.2011**

<i>Procese gjyqësore në proces</i>	11
<i>Të mbartura nga vitet paraardhëse</i>	13
Gjykatë e Lartë	7
Gjykatë e Apelit	2
Gjykatë e Shkallës së Parë	2
<i>Të përfunduara gjatë vitit 2011</i>	2
<i>Të ankimuara gjatë vitit 2011</i>	-

## **Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS)**

Autoriteti, në bazë të nenit 42, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, mbikëqyr Byronë Shqiptare të Sigurimit.

Byroja është person juridik, në përbërje të të cilit është çdo sigurues i licencuar për të ushtruar veprimtari në sigurimin e detyrueshëm motorik.

### *Roli i Byrosë gjatë veprimtarisë së saj përmbledhet në:*

- Përfaqësimin e Anëtarëve në marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare të fushës së sigurimeve, të detyrueshme në sektorin e transportit;
- Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore lidhur me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit;
- Furnizimin e Anëtarëve me Certifikatën Ndërkombëtare të Sigurimit (Kartoni Jeshil), sipas formatit të përcaktuar nga Këshilli i Byrove;
- Ratifikimin e marrëveshjeve me Byrotë homologe;
- Kryerjen e funksioneve të Byrosë trajtuese, paguese dhe të shërbimit, në përputhje me parashikimet e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove;
- Administrimin e Fondit të Kompensimit dhe Fondit të Kartonit Jeshil.

Objekt i veprimtarisë së Byrosë është përmbushja e funksioneve, detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga dispozitat e Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Ligjit 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, “Rregullorja e brendshme e Këshillit të Byrove” dhe Statuti i saj.

Byroja është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove (Shoqata Ndërkombëtare e Byrove Kombëtare të Siguruesve Motorik) dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e kartonit jeshil.

### *Qëllimi i mbikëqyrjes:*

- Garantimi i detyrimeve financiare, që rrjedhin nga anëtarësimi i Byrosë në sistemin e Kartonit Jeshil;
- Zbatimi i detyrimeve ligjore që lidhen me trajtimin e dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit;
- Zbatimi i detyrimeve të tjera ligjore që lidhen me veprimtarinë e BSHS-së.

### *Realizimi i mbikëqyrjes kryhet:*

- nëpërmjet raportimeve periodike të Byrosë lidhur me:
  - financimin, investimin dhe administrimin e Fondit të Kompensimit;
  - financimin, investimin dhe administrimin e Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil;
  - financimin, investimin dhe administrimin e buxhetit të Byrosë;
- nëpërmjet inspektimeve tematike.



Gjatë vitit 2011, Autoriteti ka ndjekur me përparësi detyrimet e shoqërive të sigurimit ndaj Byrosë për financimin e Fondit të Kompensimit e buxhetit të BSHS, si dhe kryerjen e pagesave të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit. Duke qenë se gjatë këtij viti, janë konstatuar vonesa nga shoqëritë, në plotësimin e këtyre detyrimeve dhe pagesave, nga Autoriteti janë organizuar takime të përbashkëta me drejtuesit e shoqërive të sigurimit dhe drejtorin e BSHS-së, duke propozuar dhe masa administrative ndaj shoqërive të sigurimit të cilat kanë pasur më shumë probleme.

#### **Fondi i Kompensimit**

Fondi i Kompensimit ka për qëllim pagesën e dëmeve pasurore dhe jopasurore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastet e dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i një mjete të pasiguar, të pidentifikuar dhe në rastet e mbylljes apo falimentimit të një shoqërie të sigurimit. Ai krijohet nga:

- Kontributi i përvitshëm i shoqërive të sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimin e detyrueshëm motorik;
- Arkëtime nga rimbursimi i shumave nga personat përgjegjës për dëmet të Byroja;
- Gjobat e vëna pronarit të mjetit të transportit, të cilët nuk kanë lidhur kontratat e sigurimit të detyrueshëm;
- Burime të tjera, të cilat nuk ndalohen me ligj.

Pagesat e dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit, bëhen vetëm për shumën për të cilat i dëmtuari nuk ka mundësi të përfitojë nga sigurimet shoqërore apo nga ndonjë sigures tjetër me të cilin mund të ketë lidhur një kontratë sigurimi për të përfituar dëmshpërblim.

## **2.4 Teknologjia e informacionit**

Viti 2011 është karakterizuar nga një zhvillim cilësor në infrastrukturën e sistemeve informatike lidhur me zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar shërbimeve të brendshme dhe atyre të dhëna ndaj të tretëve, por ka patur edhe mjaft risi.

Gjatë vitit 2011 janë zhvilluar aktivitete, me qëllim bashkëpunimin ndërinstitucional dhe në përmbushje të nevojave të mbikëqyrjes së tregut, operatorëve të tij, mbrojtjes së konsumatorëve si dhe aktivitete për projektimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturës informatike të brendshme të Autoritetit. Në kuadër të përmirësimit të aktivitetit të brendshëm, është siguruar administrimi i vazhdueshëm i pajisjeve, aplikimeve, bazave të të dhënave, menaxhimi i sigurisë dhe ndihma e vazhdueshme teknologjike për punonjësit e institucionit.

Në zbatim të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Shkëmbimit të Informacionit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe akteve të tjerë dypalëshe në

kuadër të saj, Autoriteti në bashkëpunim edhe me partnerët, gjatë vitit 2011 ka projektuar dhe ndërtuar sisteme të cilët ndërthurin infrastrukturën ekzistuese me kërkesat e ndërsjella institucionale. Të tilla kanë qenë shërbimi mbi raportimin e dëmeve për “Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”, DPShTRr, shërbimi mbi kontrollin në kohë reale të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik nga “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit” si dhe shërbimi mbi kontrollin e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik nga “Njësia e Kontrollit të Autostradave”.

Shërbimet e mësipërme janë rezultat i bashkëpunimit të frytshëm edhe me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) i shprehur përgjatë vitit 2011 me kurorëzimin e pjesëmarrjes së Autoritetit në rrjetin kompjuterik ndërinstitutional GovNet.

### **Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik**

Gjatë vitit 2011 është siguruar vazhdimësia e funksionimit të regjistrave elektronikë në Autoritet dhe janë realizuar edhe ndryshime strukturore, me qëllim optimizimin e aplikacioneve përbërëse dhe rritjen e shkallës së sigurisë dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve.

Autoriteti ka patur një bashkëpunim me BB për projektin mbi Liberalizimin e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri. (“The Road Ahead for Albanian Motor TPL market”). Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë kryer analiza pranë Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik dhe janë parashikuar hapat për të ardhmen me qëllim mundësimin e sistemit Bonus-Malus dhe kalimin e mirëfilltë në përjasjen e mbikëqyrjes me fokus risku.

**Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik** është realizuar dhe mirëmbahet nga Autoriteti në bashkëpunim edhe me shoqëritë e sigurimit.

Ajo përbëhet nga:

- Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike është një platformë raportimi dhe identifikimi në kohë reale të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik në formën e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar. Regjistri Elektronik është në përdorim e mirëmbajtje në Autoritet nga dhjetori 2007;
- Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike është një platformë raportimi i dëmeve të ndodhura në kuadër të sigurimeve të detyrueshme motorike. Për të mundësuar fazën e tretë të projektit, krijimin e sistemit Bonus-Malus, Regjistri i Dëmeve është plotësuar me të dhënat historike të dëmeve duke filluar nga 1 janari 2006. Regjistri i Dëmeve është në përdorim në Autoritet dhe e mirëmbahet prej tij që nga gushti i vitit 2009.



## Sistemi i Administrimit të Informacionit

Në kuadër të zhvendosjes drejt raportimit elektronik të subjekteve në mbikëqyrje, AMF ka realizuar projektin “Management Information System” (MIS). Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH).

Projekti nga ana teknike përbëhet nga një platformë raportimi web, nëpërmjet të cilës operatorët e subjekteve të mbikëqyrura raportojnë të dhënat e kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit.

Gjatë vitit 2011 është punuar intensivisht në procesin e saktësimit të funksionimit dhe ndërtimit të pjesëve të reja të sistemit si forma raportimi të plotësuar nga subjektet e mbikëqyrura dhe raporteve analitike bazuar në të dhënat e mbledhura nëpërmjet formave të raportimit.

Sistemi i instaluar në sallën e serverave të Autoritetit dhe në përdorim nga shoqëritë raportuese është në proces përdorimi dhe mirëmbajtje. Një punë e veçantë është kryer në drejtim të përgatitjes dhe realizimit të specifikimeve për të mundur vazhdimësinë e veprimtarisë së sistemit dhe aplikimin e strategjisë së vazhdimësisë së veprimtarisë dhe rimëkëmbjes nga katastrofa (“disaster recovery” dhe “business continuity”).

amfALBANIA AMF In-Reg Firms

Ballinë

Jo i regjistruar [Shqip]

**Mirë se Erdhët në AMF In-Reg Firms**

AMF In-Reg Firms i lejon përdoruesit të redaktojnë, shikojnë, vlerësojnë dhe dërgojnë formularë. Firma do të mund edhe të shikojnë çdo informacion profili të ruajtur për to me anë të vënies në përdorim të funksionit të Profilit të Firmës. Këshillohet të kontrolloni rregullisht këtë zonë për të siguruar saktësinë e informacionit.

Për të pasur të drejtën e hyrjes në AMF In-Reg Firms, lutemi të fusni poshtë emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin tuaj (fjalëkalimi është i ndjeshëm ndaj madhësisë së shkronjës):

Emri i përdoruesit:

Fjalëkalim:

[Fjalëkalim i Haruar](#)

Kriteret më minimale kompjuterike të këshilluara për të përdorur AMF In-Reg Firms janë:

- Microsoft Internet Explorer version 6 ose më sipër
- Adobe Acrobat Reader 8.0 ose më sipër
- Microsoft Excel 2003 ose më sipër
- Një lidhje me printerin në mënyrë që të mund të printoni kopje në letër të formularëve

## Sistemi Telefonik i Ndhmës së Konsumatorëve

“Sistemi Telefonik i Ndhmës së Konsumatorëve” i modifikuar dhe përshtatur nëpërmjet konfigurimit të sistemit të përgjigjes automatike përpunon telefonatat nga numri telefonik i konsumatorit nga numri pa pagesë “0800 6969” dhe nga numri “+355 4 2257557” i publikuar në faqen zyrtare të internetit [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al) dhe në çdo policë të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Sistemi jep të dhëna zanore në formë të automatizuar dhe mundëson bashkëveprimin (me zë, email, apo faqen zyrtare të internetit) me strukturat përkatëse të Autoritetit si dhe mbikëqyrjen nga drejtuesit të veprimtarisë së kujdesit ndaj konsumatorit në përgjithësi dhe çdo çështjeje në veçanti.

## 2.5 Bashkëpunimi institucional

### Bashkëpunimi me institucionet e vendit

Viti 2011 ka qenë i rëndësishëm në drejtim të nxitjes së mëtejshme të veprimtarisë së **Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar**, sipas dispozitave të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. AMF ka bashkëpunuar me **Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave** në drejtim të formalizimit të nivelit të bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve, në kuadër të përmbushjes së objektivave respektive për zhvillimin e sistemit financiar në vend dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së tij.

Nisma e përbashkët, për përgatitjen dhe firmosjen e një draft memorandum bashkëveprimi ndër institucional, me asistencën e BB-së është drejt përfundimit. Ky memorandum bashkëpunimi, do të harmonizojë dhe bashkërendojë në mënyrë formale veprimet e institucioneve në fjalë, duke ndihmuar në monitorimin dhe administrimin me efikasitet të situatave të jashtëzakonshme financiare, me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë e stabilitetit financiar të vendit.



(Nga e majta në të djathtë) Z. Avenir Peka, Zv/Ministër i Brendshëm, Zj. Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF-së dhe Z. Sokol Olldashi, Ministër i Punëve Publike dhe Transportit gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit e shkëmbimit të informacionit

Autoriteti ka bashkëpunuar ngushtë edhe me **Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit**. Në kuadër të këtij bashkëpunimi vlen të përmendet nënshkrimi i marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Shkëmbimit të Informacionit për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit, në 31 mars 2011 midis AMF-së, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Kjo marrëveshje synon sigurimin e ndihmës së ndërsjellë në drejtim të lehtësimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të

informacionit midis AMF-së dhe autoriteteve përgjegjëse për monitorimin e trafikut rrugor e kalimit kufitar, si dhe administrimin e shërbimeve të transportit rrugor. Ajo mundëson edhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve motorike që lëvizin në territorin e Republikës së Shqipërisë me kontrata sigurimi të vlefshme, zvogëlimin e numrit të mjeteve të transportit të pasiguruara, kontrollet e përbashkëta dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të qarkullimit të mjeteve motorike.

Me **Bankën e Shqipërisë**, bashkëpunimi është shumë i rëndësishëm në drejtim të arritjes së objektivave të përbashkëta për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare në vend. Shkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit midis dy institucioneve dhe



inspektimet e përbashkëta kanë rezultuar të suksesshme, duke konfirmuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi strategjik në drejtim të evidentimit të risqeve dhe transferimit të tyre brenda sektorit financiar.

AMF ka bashkëpunuar me **Autoritetin e Konkurrencës**. Në takime të vazhdueshme në nivel teknik janë diskutuar çështje që lidhen me tregtimin produkteve të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike, ngritjen e njësisë së mbrojtjes konsumatore për tregun e letrave me vlerë, etj.

Gjatë vitit 2011, Autoriteti ka mbajtur kontakte të rregullta me **Ministrinë e Integritit Evropian** dhe ka përcjellë raporte të cilat pasqyrojnë progresin e arritur në drejtim të realizimit të masave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese, në përputhje me afatet e parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Këto raporte japin edhe një përshkrim të shkallës së përputhshmërisë të akteve juridike të miratuara në fushën e tregut financiar jo-bankar me *acquis communautaire*. Konkretisht:

- Raportim (me ndërmjetësimin e Ministrisë së Integritit) pranë Komunitetit Evropian në lidhje me zhvillimet legjislative, masat, projektet dhe kapacitetet institucionale;
- Raportim i vazhdueshëm në lidhje me fushat e mbikëqyrura dhe të rregulluara nga AMF, duke ju dhënë përgjigje pyetjeve dhe kërkesave të ndryshme të cilat i drejtohen Autoritetit nga Komisioni Evropian;
- Raportim vjetor mbi zhvillimet e tregut të sigurimeve, të titujve apo pensioneve private të mbikëqyrura nga AMF;
- Raportim në Ministrinë e Integritit, në kuadër të përgatitjes së raportit të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, për takimin e datës 15 Mars 2011, në Bruksel dhe takimin e 8-9 Dhjetor 2011 në Tiranë;
- Raportim në lidhje me përditësimin e planit të veprimit të AMF në kuadrin e rekomandimeve të Raportit Analitik 2010 dhe Progres Raportit 2011 të KE;
- Raportim e rishikim periodik i PKZMSA-së, me fokus të veçantë në aspektet që lidhen me afatet e përcaktuar sipas detyrimeve të MSA-së.

Nga ana e AMF-së janë bërë përpjekje për të përfituar mbështetjen e projekteve apo programeve të ofruara nga BE, si TAIEX (*Technical Assistance and Information Exchange*), i cili ofron asistencë teknike në fushën e përafritimit dhe zbatimit të legjisllacionit komunitar.

Autoriteti është anëtar i grupit teknik të zbatimit të **Dokumentit Strategjik Kombëtar “Për hetimin e krimit financiar”**. Nëpërmjet këtij dokumenti synohet krijimi i një platforme afatgjatë veprimi për të vendosur një ekuilibër ndërmjet parandalimit efektiv dhe hetimeve të krimeve në fushën ekonomiko-financiare. Për zbatimin e këtij dokumenti të rëndësishëm për integrimin e vendit është hartuar një plan veprimi për periudhën 2009-2015. Dokumenti përcakton si objektivat afatmesme e afatgjata ashtu edhe prioritetet. Ai detajon aktivitetet të cilat do të sigurojnë përmbushjen e këtyre objektivave. Në këtë kuadër, AMF raporton çdo tre muaj pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për ecurinë e realizimit të objektivave të dokumentit strategjik.

## Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare

AMF mban një komunikim të vazhdueshëm me homologët nëpërmjet kontakteve dhe shkëmbimit të përvojës. Pjesëmarrja gjithnjë e më aktive në veprimtaritë e organizuara prej organizmave ndërkombëtarë është një domosdoshmëri në njohjen dhe përditësimin me tendencat më të fundit rregullative dhe mbikëqyrëse, si dhe zbatimin e parimeve dhe praktikave më të mira. Një faktor i rëndësishëm për intensifikimin e kontakteve me homologët dhe institucionet ndërkombëtare ka qenë dhe nevoja e harmonizimit të legjislacionit rregullues të tregjeve financiare jo-bankare me Direktivat e BE-së, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

## Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare

### Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve, IAIS

AMF është anëtare e IAIS-it që prej vitit 2001. Autoriteti është duke ndjekur me interes procesin e filluar nga IAIS për nënshkrimin e Marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit (MMoU). Kjo është një marrëveshje për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni midis anëtarëve të IAIS, me qëllim vendosjen e standardeve të domosdoshme për të forcuar mbikëqyrjen ndërkufitare të shoqërive të sigurimit. Pjesëmarrja në këtë marrëveshje multilaterale është një mjet i rëndësishëm rregullator për të siguruar një mbikëqyrje të shëndoshe të tregut të sigurimeve. Zhvillimet dinamike të tregut me shoqëritë e sigurimeve që tentojnë të zgjerojnë gjithnjë e më shumë operacionet e tyre në nivel global, si edhe kriza financiare e shoqëruar me sfida të reja, kanë bërë që AMF ta konsiderojë nënshkrimin e marrëveshjes me IAIS si një hap të rëndësishëm strategjik në axhendën e saj.

AMF ka gjithë angazhimin për ndryshimet e nevojshme në kuadrin rregullator të saj me qëllim përmbushjen e standardeve dhe firmosjen e MMoU-së.



E. Gjoni në Konferencën Globale të Sigurimeve, 2011

Edhe gjatë vitit 2011, AMF ka vazhduar bashkëpunimin teknik me shumë autoritete homologe në sektorin e sigurimeve nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca e seminare si një domosdoshmëri për marrjen e eksperiencave të reja nga vendet e përparuara.

Konferenca Vjetore - 2011 e IAIS-it me temë *“Drejt një horizonti të ri për mbikëqyrjen e sigurimeve: bashkëpunimi dhe harmonizimi ndërsektorial dhe ndërkufitar, një sfidë kyçe pas krizës për mbikëqyrjen e sigurimeve dhe industrisë”* paraqiti





sfidat e reja të tregjeve dhe ofroi alternativa zhvillimi që lidhen me mbikëqyrjen me bazë të gjerë dhe çështjet e industrisë, standardet e sigurimit, menaxhimin e riskut, mbrojtjen e konsumatorit, etj. AMF ka qenë gjithnjë pjesëmarrëse aktive në këto konferenca.

### **Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë, IOSCO**

Edhe gjatë vitit 2011 AMF ka vazhduar bashkëpunimin teknik me shumë autoritete homologe në fushën e letrave me vlerë nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca, seminare, e takime të tjera si një domosdoshmëri për përditësimin me përvojat e vendeve të përparuara.

Autoriteti merr pjesë rregullisht dhe në mënyrë aktive në Mbledhjet e Përgjithshme Vjetore të IOSCO-s që shërbejnë si një forum për shkëmbimin e pikëpamjeve në fushën e ruajtjes dhe përmirësimit të kuadrit rregullator ndërkombëtar të tregjeve të letrave me vlerë përmes vendosjes së standardeve ndërkombëtare, identifikimit dhe trajtimit të rreziqeve të sistemit si dhe çuarjen përpara të përmbushjes së *Objektivave dhe Parimeve të IOSCO-s*. AMF është tashmë nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të IOSCO-s, dhe po punon në ndjekjen e zbatimit të plotë të tij për konsultimet, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me autoritetet homologe brenda MMoU-së.

Në prill 2011, Organizata Ndërkombëtare e Komisionerëve të Letrave me Vlerë (IOSCO) zhvilloi Konferencën e 36-të Vjetore në Cape Town, në Afrikën e Jugut. Një numër i madh vendimesh me shumë rëndësi u morën në këtë Konferencë për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të cilat AMF ka gjithë angazhimin e saj. Gjithashtu, AMF është e përfshirë edhe në Komitete dhe struktura të veçanta të IOSCO-s rajonale e më gjerë dhe ndjek e punon në kuadrin e tyre në mënyrë profesionale.

### **Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve, IOPS**

Anëtarësimi në Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve, IOPS, është një angazhim që AMF e ka vlerësuar vazhdimisht. Ky anëtarësim ka synuar të ndihmojë në krijimin e urave të bashkëpunimit në nivel global në mes të gjithë palëve të interesuara për mbikëqyrjen e sistemit të pensioneve. Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të AMF-së në mbledhje vjetore e takime të tjera rajonale ka ndihmuar në njohjen me praktikatat më të mira në fondet e pensioneve private dhe promovimin e qasjeve të reja të bazuara në risk në mbikëqyrjen e sistemit të pensioneve. AMF ka qenë e angazhuar në plotësimin e të gjithë detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja në këtë organizatë. Ajo vazhdon të plotësojë kuadrin rregullator me ndryshimet e duhura me qëllim përafrimin me legjisllacionin e BE-së.

## Bashkëpunimi me institucione homologe

Komunikimi i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit ka qënë i domosdoshëm në drejtim të përmbushjes së rolit rregullativ të AMF-së, për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve financiare jo-bankare.

Bashkëpunimi me **Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK)**, ka hyrë në një fazë konsolidimi sidomos në mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në të dy vendet, pasi shoqëritë shqiptare të sigurimit kanë peshë jo të vogël në tregun e Kosovës. Marrëveshja e Mirëkuptimit midis AMF-së dhe BQK-së ka ndikuar pozitivisht në rritjen e efektivitetit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ekspertizës midis dy institucioneve.

Bashkëpunimi me **Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, ISA**, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis të dy Autoriteteve ka marrë rëndësi të madhe. Kjo edhe për kushtet aktuale të shtrirjes së veprimtarisë të kompanive shqiptare të sigurimit në territorin e Maqedonisë. Marrëveshja e cila është tashmë në vitin e dytë të zbatimit ndikoi pozitivisht në integritetin, stabilitetin dhe efikasitetin e industrisë së sigurimeve të të dy vendeve duke shtrirë bashkëpunimin në të gjitha kanalet e komunikimit, rritjen e mirëkuptimit reciprok dhe shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave.

Organizimi i seminarit rajonal mbi sfidat në harmonizimin e legjislacionit dhe mbikëqyrjes kombëtare të sigurimeve në përputhje me kërkesat rregullatore të BE, nga Autoriteti i Maqedonisë, ISA në Ohër synonte analizën e strukturës së re të mbikëqyrjes në EU dhe sfidat me të cilat përballen vendet e rajonit për implementimin e standardeve të direktivës së Solvency II e mbikëqyrjes me fokus risku. Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me ISA-n stafi i AMF-së ka marrë pjesë edhe në workshopin rajonal për Metodologjinë e "Mbikëqyrjes me Fokus Riskun". **USAID, Programi PFS** mbështeti këtë event. USAID, PFS Program ka mbështetur gjithashtu edhe organizimin e Takimit Rajonal të Shoqatave aktuariale nga Evropa Juglindore në Zagreb, Kroaci. Takim u organizua nga Shoqata Aktuariale Kroate në bashkëpunim me Shoqatën Aktuariale Ndërkombëtare (IAA) dhe synonte mbështetjen e rritjes dhe sofistikimit të sektorit të sigurimeve nëpërmjet shkëmbimit të përvojave duke vënë në zbatim standardet ndërkombëtare për aktuarët. Gjithashtu, Shqipërisë ju bë ftesa për t'iu bashkuar grupit të gjerë të Shoqatës Aktuariale Ndërkombëtare (IAA), pjesëmarrja në të cilën do i ndihmojë aktuarët tanë, jo vetëm në njohjen e metodave të reja aktuariale, por edhe në shkëmbimin e përvojave mes shteteve përfaqësuese në vazhdimësi.

AMF e ka shtrirë bashkëpunimin e saj edhe me autoritete homologe të tjera në Evropë. Gjatë vitit 2011 është konsoliduar bashkëpunimi me **Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë, FMA**. Kjo edhe për faktin se janë rritur interesat austriake në tregun shqiptar të sigurimeve me rritjen e investimeve austriake në vend. Edhe Marrëveshja e



Bashkëpunimit e nënshkruar midis AMF-së dhe autoritetit austriak, FMA ka shërbyer për shkëmbimin më tej të eksperiencës midis dy autoriteteve rregulatore.

Në prill të 2011, FMA-ja e Austrisë në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Hungarisë, HFSA u bënë nismëtarë të Iniciativës Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. AMF ishte pjesëmarrëse aktive e kësaj iniciative. Takimi i parë iniciues, “CESEE Meeting, 1” u zhvillua në Vjenë, Austri dhe u fokusua në tematikat e Solvency II – *implementimi i kolonës së dytë; kolegjet mbikëqyrëse; mbrojtja e konsumatorit dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve; sigurimi i detyrueshëm motorik, etj.* Takimi rezultoi i suksesshëm, si një forum me diskutime dhe shkëmbime eksperiencash të vlefshme duke hapur rrugën për një bashkëpunim më efektiv në të ardhmen ku rregullatorët nga vendet e CESEE mundën të diskutonin mbi çështjet e përbashkëta që hasen në rregullimin e tregut të sigurimeve në këto vende.

Po në kuadrin e kësaj nisme, AMF ishte vendi mikpritës i “CESEE Meeting, 2” të organizuar në tetor 2011. Bashkëorganizator në këtë aktivitet ishte edhe **FSA e Hungarisë**. Takimi synoi ngritjen në një nivel më të lartë të bashkëpunimit mes mbikëqyrësve të sigurimeve në rajon i cili ishte iniciuar që tek “CESEE Meeting, 1”. Takimi u fokusua në tematikat si: provigjonet e dëmeve; shpërndarja e sigurimeve – ndërmjetësit; roli i aktuarit në autoritetin rregullator; testet e aftësisë dhe përshtatshmërisë dhe problematika e lidhur me to; si dhe “shkëmbimi i informacionit mbi risqet e konsumatorit, specifike për sigurimet, etj. Takimi konfirmoi suksesin dhe rezultatet që arrihen nëpërmjet diskutimeve dhe shkëmbimit të ekspertizave midis rregullatorëve të pranishëm.



Konferenca e Dytë Rajonale e mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore e Juglindore

Gjithashtu gjatë vitit 2011, AMF ka vazhduar bashkëpunimin edhe me organizma të tjerë që veprojnë në fushën e tregut të sigurimeve në **Austri si Shoqata e Sigurimeve të Austrisë, VVO.**

### **Bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët**

Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e suksesshme me donatorët kanë vazhduar t'i shërbejnë realizimit të projekteve strategjike dhe rritjes së kapaciteteve institucionale të AMF-së.

AMF-ja po zbaton projektin “Strategjia për tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik” një bashkëpunim me **Bankën Botërore**, të financuar nga **First Initiative**. Projekti, i cili ka disa faza, synon diagnostikimin e situatës aktuale në tregun e sigurimit të detyrueshëm

motorik, zhvillimin e politikave dhe proceseve drejt tarifimit me fokus riskun të produkteve të sigurimit të detyrueshëm motorik, si edhe përfrimin e kuadrit aktual ligjor që rregullon sigurimin e detyrueshëm motorik me direktivat e BE-së. Projekti është shumë aktual për tregun shqiptar të sigurimeve, ku tashmë është hequr me ligj regjimi i tarifave fikse në sigurimin e detyrueshëm motorik. Ai lehtëson gjithashtu tranzicionin drejt një tarifimi më eficient, që është ai me fokus riskun.

AMF në kuadër të projektit *“Për Mbikëqyrjen Efektive”* që u zhvillua me asistencën e BB dhe me financimin e First Initiative hartoi Manualin e Mbikëqyrjes me Fokus Riskun, së bashku me Planin Strategjik të Zbatimit. Të dy këto dokumente të rëndësishëm u miratuan nga Bordi i AMF-së në tetor 2011. Manuali është i pari i këtij lloji dhe ai synon reformimin e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve duke i kushtuar vëmendje më e madhe operatorëve që paraqesin risk më të lartë.

Autoriteti është i përfshirë në nisma të tjera rajonale të asistuar nga BB. Kështu BB ka mbështetur krijimin e një organizmi *“Europa Reinsurance Facility - Europa Re LTD”*. Ky është një organizëm me qëllim jo përfitimi që drejtohet nga një bord i pavarur drejtorësh dhe menaxhohet nga një ekip profesionistësh të zgjedhur nga përfaqësues të qeverive të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë. Krijimi i Europa Re synon të lehtësojë tregjet nga dëmet nga katastrofat natyrore kombëtare me anë të krijimit dhe prodhimit të produkteve të reja të lira të sigurimeve, adoptimit të produkteve teknologjike më të përparuara, reformës rregullatore, edukimit të konsumatorëve dhe të ofrimit të shërbimeve të risigurimit. Europa Re është aktualisht në procesin e krijimit të infrastrukturës teknike të nevojshme. Kjo infrastrukturë do të mundësojë zhvillimin e një platforme dixhitale për automatizimin e veprimtarive dhe krijimin e modeleve të sigurimit dhe risigurimit kundër tërmetit dhe përmbytjeve. Me mbështetjen e Qeverisë është ngritur dhe një grup ndërinstitucional pune për këtë projekt, ku anëtarë janë **Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Banka e Shqipërisë dhe Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.**

AMF edhe gjatë vitit 2011 ka bashkëpunuar ngushtësisht me USAID nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Sektorit Financiar në Shqipëri, i cili zbatohet nga Financial Services Volunteer Corps (**FSVC**), Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare. Në përgjigje edhe të rekomandimeve të BB, për të zbatuar metodologjinë e mbikëqyrjes me fokus risku për tregun e sigurimeve, AMF dhe FSVC, kanë hartuar një program trajnimi për stafin teknik për tema të interesit të veçantë që lidhen me mbikëqyrjen me fokus risku në të gjitha aspektet e saj.

Bashkëpunimi i vlefshëm me FSVC-në dhe USAID-in në fushën e aktuaristikës u finalizua me dhënien e diplomave aktuarëve profesionistë gjatë ceremonisë organizuar me këtë rast në maj 2011. AMF ka shprehur vazhdimisht gatishmërinë dhe vullnetin për të rritur dhe zhvilluar këtë profesion në nivele më të larta, bazuar në parimet dhe normat e përcaktuara



## 2.6 Integrimi Evropian

Anëtarësimi i Shqipërisë në BE është një proces mjaft dinamik, i cili varet nga përmbushja e kriterëve të Kopenhagenit miratuar në vitin 1993 dhe veçanërisht nga aftësia e Shqipërisë për t'u përshtatur me ndryshimet e vazhdueshme të *acquis communautaire* dhe transpozimin e tyre të plotë në sistemin ligjor shqiptar.

Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe aplikimi për anëtarësim në BE, megjithëse janë në thelb dy procese të veçanta, kërkojnë harmonizimin e legjislacionit dhe zbatimin e *acquis communautaire*, si dhe forcimin e kapaciteteve administrative që të çojnë në fazën e ardhshme të procesit të integritit, në atë të pranimit në BE.

AMF që nga krijimi në vitin 2006 si autoriteti i vetëm rregullator dhe mbikëqyrës për sektorin financiar jo-bankar ka thelluar gjithnjë përpjekjet për përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e bazës rregullatore të nevojshme për një zhvillim sa më normal dhe të qëndrueshëm të tregjeve financiare jo-bankare. Një nga objektivat kryesore të Autoritetit ka qenë hartimi dhe miratimi i legjislacionit rregullator dhe mbikëqyrës në fushën e shërbimeve financiare jo-bankare duke mundur zhvillimin e mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit. Për përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues dhe përafrimit me direktivat e BE-së, AMF ka hartuar dhe një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore me qëllim ngritjen dhe përforcimin e proceseve rregullatore dhe mbikëqyrëse të qarta, transparente dhe të qëndrueshme.

### Angazhimet e AMF-së në kuadër të Dokumenteve Strategjike

#### *Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, MSA*

Detyrimet që rrjedhin nga MSA për AMF-në lidhen me përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit për anëtarësim në BE, garantimin e së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime financiare jo-bankare, si dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar (*acquis communautaire*) në këto fusha.

**Neni 70** i MSA-së parashikon detyrimin për përafrimin e legjislacionit në këtë fushë gjatë fazës së parë transitore. Në **Nenin 50** të saj, Shqipëria është angazhuar që me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, t'u ofrojë shoqërive komunitare si dhe degëve dhe filialeve të tyre një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u njihet kompanive, degëve apo filialeve shqiptare. Në **Nenin 57** të Marrëveshjes, Shqipëria angazhohet të lejojë progresivisht ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë komunitare, pa qenë nevoja për t'u vendosur. **Neni 89** i MSA-së përcakton për një bashkëpunim prioritar ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën bankare, të sigurimeve dhe shërbimeve financiare. Palët duhet të bashkëpunojnë me qëllim vendosjen dhe zhvillimin e një kuadri të përshtatshëm për nxitjen e sektorit bankar dhe financiar jo-bankar.

#### *Partneriteti Evropian 2007*

Në kuadër të dokumentit të Partneritetit Evropian 2007 është marrë angazhim të forcohet kuadri rregullator për mbikëqyrjen financiare bankare dhe jo-bankare, si dhe kapacitetet e Autoritetit.

### **Rekomandimet e Raportit Analitik 2010 dhe Progres Raportit 2011**

AMF-ja ka marrë angazhime për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të sektorit financiar jo-bankar me Direktivat Evropiane, si dhe përforsimin e kapaciteteve institucionale me qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen sa më efektive të sektorit financiar jo-bankar.

Autoriteti është angazhuar në procesin e rishikimit dhe hartimit të PKZMSA-së për periudhën 2012-2015, e cila do të përfshijë të gjitha masat për zbatimin e detyrimeve të MSA-së, si dhe masat për transpozimin e *acquis communautaire* së BE.

Për këtë qëllim Autoriteti ka dhënë kontributin e tij, ku në këtë plan është parashikuar jo vetëm përmbushja e detyrimeve që burojnë nga MSA-ja, por edhe përafrimi me legjislacionin e BE-së dhe zbatimin e tij për sektorin financiar jo-bankar.

### **Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA)**

#### ***Çdo vend kandidat që aspiron të bëhet anëtar i BE-së, është i detyruar që të përgatisë një plan kombëtar për miratimin e *acquis communautaire****

PKZMSA është një dokument i konsoliduar që përfshin në tërësinë e tij prioritetet dhe masat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të Shqipërisë për zbatimin e MSA-së në procesin e integritimit evropian, duke u fokusuar veçanërisht në:

- Prioritetet e Partneritetit Evropian për Shqipërinë të vitit 2007;
- Rekomandimet e Progres Raporteve vjetore të KE-së;
- Zbatimin e angazhimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- Përcaktimin e prioriteteve për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*;
- Përcaktimin dhe detajimin e kapaciteteve administrative të nevojshme për zbatimin e angazhimeve të MSA-së sipas fushave;
- Përcaktimin e kostove financiare për zbatimin e angazhimeve të MSA-së, në përputhje me planin buxhetor afatmesëm dhe me kostot e tjera financiare, të përcaktuara në strategjitë sektoriale.

AMF mori pjesë në takimin e tretë të Nënkomitetit BE-Shqipëri për “Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën” që u zhvillua në Bruksel, në datën 15 prill 2011. Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i zhvillimeve legjislative dhe institucionale të Shqipërisë në fushat e tregut të brendshëm dhe konkurrencës dhe vlerësimi nga pala evropiane e progresit të bërë nga Shqipëria në përmbushjen e angazhimeve që burojnë nga dokumentet strategjike si MSA, Partneriteti Evropian, Raporti Analitik KE 2009-2010, angazhimet e ndërmarra në PKZMSA 2010-2014. Autoriteti në këtë takim paraqiti një raport mbi fushat të cilat rregullohen dhe mbikëqyren nga ky institucion: sigurimet, letrat me vlerë dhe pensionet vullnetare, duke u fokusuar në aspektin e zhvillimeve legjislative, ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale gjatë vitit të kaluar.



## Adresimi i rekomandimeve të Raportit Analitik dhe Progres Raportit të KE-së dhe angazhimi i AMF-së në hartimin e plan veprimit në kuadër të tyre

Autoriteti në vijim të Raportit Analitik të KE-së të muajit nëntor 2010 dhe Progres Raportit të vitit 2011, pasi analizoi rekomandimet e adresuara në këto raporte në lidhje me Kapitullin 9 “Shërbimet financiare” si dhe ato të bëra në pjesën e “Kriterit ekonomik” ka hartuar një plan veprimi ku përcaktohen objektivat e tij në drejtim të nismave ligjore dhe forcimit të kapaciteteve institucionale.

### Acquis communautaire

*Acquis communautaire është tërësia e të drejtave dhe e detyrimeve të përbashkëta që i bashkon të gjitha shtetet anëtare në Bashkimin Evropian. Acquis communautaire ndryshohet vazhdimisht.*

Acquis përfshin:

- Përmbajtjen, parimet dhe qëllimet politike të Traktateve;
- Legjislacionin e miratuar në zbatim të traktateve dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të BE-së;
- Deklaratat dhe rezolutat e miratuara nga BE;
- Masat në lidhje me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë;
- Masat në lidhje me drejtësinë dhe punët e brendshme;

Marrëveshjet ndërkombëtare të përfunduara nga Komuniteti dhe marrëveshjet e përfunduara me shtetet anëtare ndërmjet njëra-tjetres në fushën e veprimtarive të BE.

### Angazhime të tjera

- Në kuadrin e zbatimit të detyrimeve dhe angazhimeve që Republika e Shqipërisë ka ndaj Organizatës Botërore të Tregtisë, OBT, më 22-23 Shtator 2011, u zhvillua në Gjenevë, Zvicër, takimi i Këshillit të Tregtisë së Mallrave të OBT-së, i cili mori në shqyrtim raportin e *Factual Presentation* në lidhje me ekzaminimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë Shqipëri-BE në shërbime si pjesë e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Në hartimin e raportit të *Factual Presentation*, i cili shërben si bazë për shqyrtimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë Shqipëri-BE, një kontribut të veçantë ka dhënë edhe AMF për pjesën e shërbimeve financiare jo-bankare. Autoriteti ishte pjesë e delegacionit të Shqipërisë, si një nga institucionet kontribuese për përgatitjen e raportit *Factual Presentation*.
- Me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 93, datë 04.11.2011 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen dhe organizimin e veprimtarive në kuadër të marrëveshjes CEFTA, (Marrëveshja e Tregëtisë së Lirë të Vendeve të Evropës Qendrore) për vitin 2012”, AMF është caktuar anëtar i grupit ndërinstitucional të

punës për përgatitjen dhe organizimin e veprimtarive në kuadër të kësaj marrëveshje, ku Republika e Shqipërisë ka drejtimin e CEFTA-s për vitin 2012.

- AMF ka kontribuar edhe në plotësimin e *Draft Skedulit* të tregtisë së shërbimeve, në kuadër të marrëveshjes CEFTA për pjesën e shërbimeve financiare jo-bankare, i cili do të shërbejë si dokument bazë për hapjen e negociatave për shërbimet në CEFTA.

## 2.7 Marrëdhëniet me publikun, transparenca

Komunikimi i pandërprerë me publikun, në përmbushje të rolit themelor Mbrojtjes së Konsumatorit, ka qenë edhe gjatë vitit 2011 një ndër prioritetet e punës së AMF-së. Publikut i është ofruar informacion i gjerë në lidhje me tregjet financiare jo-bankare dhe kjo falë edhe informacionit të duhur që ai ka marrë nga materialet e ofruara nga Autoriteti.

AMF përdor një larmi formash dhe metodash për të arritur një komunikim sa më efektiv me publikun, ku mund të përmendim fletëpalosjet, buletinet mujore informuese për të tre tregjet, botimet periodike vjetore, komunikimin nëpërmjet faqes zyrtare të Internetit si edhe prezantimet në shtypin e shkruar dhe daljet e drejtpërdrejta në median vizive.

Publikimet e ndryshme me karakter informativ dhe edukativ, kanë synuar njohjen e konsumatorëve me tregun financiar jo-bankar, mënyrën e funksionimit të tij. Gjatë vitit 2011 u botuan *Raporti i Mbikëqyrjes, Gjeografia e Sigurimeve, Buletini Zyrtar*, si edhe një numër fletëpalosjesh *Mbikëqyrja me Fokus Riskun, AMF In-Reg, Tregu Financiar Jo-bankar, Statistika 2010*.

Në kuadër të Rregullores së miratuar nga Bordi i Autoritetit "*Mbi organizimin e veprimtarisë kërkimore në AMF*" nr. 177 datë 13.12.2011 u publikua Materiali i Diskutimit "*Pavarësia e rezervuar për AMF*". Ky është materiali i parë i një serie me studime që planifikohet të botohen nga AMF.

### Botimet e AMF-së

- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Gjeografia e Sigurimeve
- Buletini Zyrtar

### Publikime elektronike të AMF-së

- Periodiku i AMF-së
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private vullnetare\*

\*Rikonceptim i Buletinit Statistikor në përmbushje të kërkesave të ligjit të ri të pensioneve

Faqja zyrtare e AMF-së është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, duke dhënë informacion të vlefshëm si për shoqëritë e sigurimit ashtu edhe për publikun si konsumator i këtyre shërbimeve. Gjithashtu ajo i shërben edhe investitorëve apo analistëve të huaj, që ata të kenë një dritare informacioni për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare jo-bankare në Shqipëri. Një vëmendje e veçantë i kushtohet përditësimit të faqes zyrtare me informacione të rëndësishme që lidhen me aktivitetin e





AMF-së dhe Bordit të saj. Këtu vlen të përmenden njoftimet me karakter orientues dhe statistikor, marrëveshjet e AMF-së si edhe informacione edukuese për produktet financiare jo-bankare dhe rëndësinë e tyre.

Raportet periodike statistikore e financiare, që AMF publikon, me periodicitet mujor, 3-mujor, 6-mujor dhe vjetor, japin një pamje të qartë të dinamikës së zhvillimit të tregjeve financiare jo-bankare dhe plotësojnë nevojat për informacion me karakter financiar, për një numër të gjerë përdoruesish. Këto raporte janë në shqip dhe anglisht.



Takimi i Kryetares së AMF-së me mediat, dhjetor 2011

Viti 2011 ka qenë vit aktiv për AMF-në në pasqyrimin e aktivitetit të saj në median e shkruar dhe elektronike. Media e shkruar dhe elektronike ka shërbyer gjithashtu për të përcjellë publikut mesazhin e AMF-së, në funksion të fushatave sensibilizuese në drejtim të mbrojtjes dhe ndërgjegjësimit të konsumatorit. Ndër tematikat më të pasqyruara në media kanë qenë:

- Rritja dhe forcimi i mëtejshëm i mbikëqyrjes së AMF-së në drejtim të tregjeve financiare jo-bankare;
- Projekt ligji i ri “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si një ligj me risi në favor të konsumatorëve;
- Zhvillimet në tregun e sigurimeve, letrave me vlere e pensioneve private vullnetare në Shqipëri,
- Liberalizimi i MTPL-së, etj.

Publikimi i projekteve ligjore në proces në faqen zyrtare të AMF-së, para miratimit të tyre, ka rezultuar një mënyrë efektive dhe transparente komunikimi në mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve të ndryshme nga të gjitha palët e interesit dhe publikut të gjerë. Në dhjetor të vitit 2011, Autoriteti publikoi në faqen zyrtare projektligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” me qëllim, forcimin dhe zhvillimin e sektorit të sigurimeve në vend.

AMF ka vijuar të informojë publikun nëpërmjet periodikut elektronik mujor, i cili përmban informacione të larmishme në lidhje me zhvillimet e sektorit financiar jo-bankar në Shqipëri, si dhe me zhvillimet dhe tendencat globale më të fundit të rregullimit të tregjeve financiare jo-bankare. Në rubrikën, edukimi i konsumatorit, kryesisht përfshihen punime mbi shërbimet dhe produktet financiare, të cilat janë nën juridiksionin e AMF-së. Po kështu një rubrikë e veçantë i kushtohet dhe praktikave më të mira të përshtatura nga tregjet e ndryshme dhe shoqatat



Z. Sali Berisha, Kryeministër dhe Zj. E. Gjoni në ceremoninë e inaugurimit të godinës së AMF-së

ndërkombëtare të rregullatorëve.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe komunikimit me palët e interesit duke u prezantuar atyre reformat dhe strategjitë me ndikim të pritsëm në tregje.

Në 31 mars 2011 AMF përuroi godinën e re të saj, e cila u bë e mundur pas shumë zhvillimesh pozitive dhe një pune të suksesshme që nga krijimi i AMF-së në tetor të vitit 2006. Kryeministri i vendit preu shiritin e inaugurimit në shenjë simbolike të përkrahjes

dhe mbështetjes së vazhdueshme që Qeveria i ka dhënë AMF-së në forcimin e rolit si rregullator i integruar i tregjeve financiare jo-bankare.

### **AMF përuroi godinën e re të saj.**

Godina e re përmbush të gjitha kriteret për t'u cilësuar si një godinë me infrastrukturë moderne dhe garanton vazhdimësi të objektivave ambicioze të institucionit. Godina e rikonstruktuar 3 katëshe, ka 23 zyra, një sistem modern Audio-Video Konference, salla takimesh në çdo kat dhe garanton realizimin e projekteve të institucionit në drejtim të Teknologjisë së Informacionit si Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik dhe Platforma elektronike e raportimit të subjekteve në AMF.

## Kapitulli 3

### Mbrojtja e Konsumatorit



#### Mbrojtja konsumatore një nga prioritetet strategjike të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Një ndër objektivat e Autoritetit është edhe mbrojtja e konsumatorit dhe interesave të tij. Ky objektivi realizohet përmes komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të konsumatorit, krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të procedurave dhe praktikave të trajtimit të ankesave të konsumatorëve duke inkurajuar dhe rritur besimin e tij në rolin e AMF-së.

Autoriteti ka shtuar mjetet e tij për t'i siguruar konsumatorit gjithë informacionin e nevojshëm, transparencën e vazhdueshme, me synimin që konsumatori të krijojë besimin dhe siguri për vendimet që do të marrë në lidhje me zgjedhjen e duhur. Autoriteti ndihmon konsumatorin duke ndërhyrë pranë subjekteve financiare jo-bankare për të korrigjuar një gabim apo duke shpjeguar rrugën ligjore në mënyrë sa më të qartë për konsumatorin.

Autoriteti synon që konsumatori të ketë në dispozicion informacion të plotë e transparent, në mënyrë që të jetë në gjendje të përzgjedhë dhe të vlerësojë situatën që i paraqitet. Aktet ligjore në fuqi detyrojnë edhe subjektet financiare jo-bankare t'i ofrojnë konsumatorit informacionin e përditësuar, në lidhje me produktet që ofrojnë, kushtet e kontratës, detyrimet e palëve, rastet dhe mënyrat e zgjidhjes së plotë apo të pjesshme të kontratës, përfitimet që rrjedhin nga kontratat, etj.


AMF, në mënyrë të vazhdueshme informon konsumatorin (nëpërmjet medias vizive dhe të shkruar) për mundësinë që i ofrohet për të kërkuar sqarime apo ndërhyrje institucionale në lidhje me kontratat e sigurimit.

Gjithashtu, Autoriteti në faqen zyrtare në Internet, [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al) i ofron çdo personi të sigurojë mundësinë për të verifikuar nëpërmjet Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, vlefshmërinë e policës së tij të sigurimit. Po kështu në këtë faqe zyrtare në Internet gjendet Sistemi GSRM, (tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë), i cili ka hapur një dritare që publiku të mund të njihet drejtpërdrejt me zhvillimet e fundit të këtij segmenti të tregut të letrave me vlerë.

Një mjet tjetër efikas në mbrojtje të interesave të konsumatorit është funksionimi pranë AMF-së, i njesisë së mbrojtjes konsumatore. Kjo njësi trajton ankesat për të gjitha rastet që paraqiten si për vonesat në trajtimin e dëmeve ashtu dhe për ankesa ndaj refuzimit apo masës së dëmshpërblimit. Procedurat e AMF-së fillojnë që me njohjen e praktikës së dëmit, sugjerimet ndaj shoqërisë së sigurimit për trajtim në përputhje me legjislacionin në fuqi, kontaktet e vazhdueshme me shoqërinë e sigurimit për zgjidhje sa më optimale të çështjes së ankimuar, etj.


Gjatë vitit 2011, Autoriteti ka trajtuar 59 ankesa në lidhje me funksionimin e sistemin e dëmshpërblimit që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

**Grafiku i ankesave dhe zgjidhjet 2007-2011 (në numër)**



Njësia për mbrojtjen e konsumatorit vepron si për konsumatorin e tregut të sigurimeve, të tregut të letrave me vlerë, ashtu edhe tregut të pensioneve private vullnetare.

**Më poshtë paraqiten mjetet e Autoritetit me qëllim mbrojtjen e konsumatorit:**



**Shërbimi i konsumatorit**

Sistemi telefonik në mbrojtje të konsumatorit, përfshin numrin fiks si dhe numrin jeshil, ku bëhet i mundur aksesimi i shërbimeve pa pagesë nga ana e konsumatorëve.

Gjatë vitit 2011, ky shërbim, nëpërmjet linjës telefonike ka pasur një numër të konsiderueshëm të telefonatave. Nëpërmjet këtij shërbimi konsumatori ka bërë pyetje kryesisht për produktet e ofruara nga shoqëritë e sigurimit apo ka paraqitur një ankesë në lidhje me ofrimin e këtyre produkteve.

Njësia për mbrojtjen konsumatore ka shqyrtuar sipas problematikave me seriozitet mesazhet zanore, si dhe sipas rasteve ka bërë të mundur dërgimin e tyre për shqyrtim në sektorët përkatës.

## PJESA II TREGJET E MBIKËQYRURA




### II.1 Tregu i sigurimeve

#### Vështrim i përgjithshëm

Gjatë vitit 2011, industria shqiptare e sigurimeve vazhdoi të njohë rritje, megjithëse me një ritëm më të ulët se viti i kaluar. Numri i shoqërive që kryejnë aktivitetin e sigurimit në Shqipëri ka mbetur i pandryshuar. Në vitin 2011 vijuan të ushtrojnë aktivitetin dhjetë shoqëri sigurimi, nga të cilat gjashtë shoqëri të sigurimit të Jo-Jetës, dy shoqëri të sigurimit të Jetës, një shoqëri kompozite e Jetës dhe Jo-Jetës dhe një shoqëri e Jo-Jetës dhe shoqëri Risigurimi.

#### Zhvillimi i tregut të sigurimeve në vite

(mln lekë)



Në vitin 2011 tregu i sigurimeve ka patur një rritje prej afro 0.2% për primet e shkruara bruto, krahasuar kjo me një vit më parë. Primet e shkruara bruto për vitin 2011 kapën shifrën rreth 8.2 miliard lekë. Rritja e tregut të sigurimeve për vitin 2011 është nxitur kryesisht nga dinamika e rritjes së sigurimeve vullnetare dhe veçanërisht nga sektori i Jetës, i cili zë 11% të totalit të primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve.


Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës kapën shifrën 0.9 mld lekë në vitin 2011, që i korrespondon një rritje prej 11% për primet e shkruara bruto, krahasuar me vitin e mëparshëm. Sigurimi i Jetës vazhdon të jetë i lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies, kryesisht për individët.

Tregu i sigurimit të Jo-Jetës në vitin 2011, pësoi një tkurrje krahasuar me vitin 2010, duke u ulur me rreth 0.6% për primet e shkruara bruto. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës në vitin 2011 kapën shifrën 7.3 mld lekë.

**Tabela 14: Primet e shkruara bruto të sigurimit dhe ndryshimi, 2009-2011\***

Veprimtaria	Primet e shkruara bruto			Primet e shkruara bruto			Ndryshimi në %		Ndryshimi në %	
	(mln lekë)			(mijë Euro)			(në Lekë)		(Euro)	
	2009	2010	2011	2009	2010	2011	2009/10	2010/11	2009/10	2010/11
Jeta	721	848	941	5,456	6,157	6,707	18	11	13	9
Jo-Jeta	7,084	7,296	7,256	53,630	52,954	51,717	3	-0.6	-1	-2
Risigurimi	72	55	18	545	401	131	-23	-67	-27	-67
<b>Total</b>	<b>7,877</b>	<b>8,200</b>	<b>8,215</b>	<b>59,632</b>	<b>59,511</b>	<b>58,555</b>	<b>4</b>	<b>0.2</b>	<b>-0.2</b>	<b>-1.6</b>

### Struktura e tregut të sigurimeve 2011



### Dendësia e sigurimit\*\*

Në vitin 2011, primi për frymë ishte mesatarisht 2,901 lekë (20.68 Euro). Nga kjo shumë, 332 lekë është shpenzuar në sigurimin e Jetës dhe 2,562 në sigurimin e Jo-Jetës. Në total, kjo është 334 lekë më shumë se sa në vitin 2010.

### Primet e sigurimit të Jo-Jetës

Pas dy vitesh ku tregu i sigurimeve të Jo-Jetës pati të ardhura të qëndrueshme, viti 2011 shënoi një ulje të primeve të shkruara bruto me rreth 0.6%, krahasuar me vitin 2010, duke arritur një vlerë prej afro 7.3 mld lekë.


\* Kursi mesatar vjetor i këmbimit në Euro sipas viteve përkatëse, marrë nga faqja zyrtare e Bankës së Shqipërisë, [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

\*\* Popullsia 01.10.2011 [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)




### Primet e shkruara bruto, Jo-Jeta, 2002-2011

(mln lekë)




### Ndarja e primeve të Jo-Jetës, 2011



Me më shumë se 60% e të ardhurave të totalit të Jo-Jetës i zë sigurimi motorik, duke pasur peshën kryesore në treg. Kjo ka bërë që konkurrenca në këtë segment të jetë e fortë. Në vitin 2011, primet e shkruara bruto në sigurimin motorik arritën vlerën 4.4 miliard lekë, kundrejt 4.8 mld lekë në vitin 2010. Rënia prej 10% e primeve të sigurimit motorik lidhet kryesisht me liberalizimin me ligj të këtij tregu në gusht 2011, ku efektin kryesor ulës e ka dhënë MTPL-ja e brendshme. Nëse portofoli MTPL-së së brendshme do të ruante të njëjtin nivel të ardhurash si të një viti më parë, por me dinamikën e rritjes së numrit të kontratave që i takon vitit 2011, tregu i sigurimeve në tërësi do të njihnte një rritje në masën 13%.

## Sigurimi motorik, primet e shkruara bruto 2002-2011

(mln lekë)



### Sigurimet e detyrueshme

Gjatë vitit 2011, sigurimet e detyrueshme motorike (të përgjegjësishë së mbajtësve të mjeteve motorike ndaj palëve të treta) për të parin vit nuk dominuan në strukturën e tregut, duke sjellë rreth 45% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve. Ky ndryshim i strukturës së ndarjes së tregut në favor të sigurimit vullnetar ka ardhur dhe si pasojë e rënies së ndjeshme të volumit të primeve të shkruara bruto në portofolin MTPL-së së brendshme.

Primet e shkruara bruto të sigurimit MTPL e brendshme, në vitin 2011, arritën në rreth 2.2 miliardë lekë, ose rreth 25% më pak se në vitin 2010.

Në vitin 2011, primet e shkruara bruto të portofolit Kartoni Jeshil ishin rreth 1.1 miliardë lekë ose rreth 22% më shumë se në vitin 2010.

Në vitin 2011, primet e shkruara bruto të portofolit Sigurimi Kufitar ishin rreth 0.4 miliardë lekë ose rreth 2% më shumë se në vitin 2010.

### Sigurimet vullnetare\*

Në vitin 2011, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në rreth 4.5 miliardë lekë, ose 13% më shumë se të ardhurat e një viti më parë. Kjo rritje ndjehet si në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës po ashtu dhe në sigurimet e Jetës.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës me të ardhura rreth 3.5 miliardë lekë, portofolet me peshë specifike më të lartë janë zjarri dhe dëmtimet në pronë me rreth 32%, të pasuara nga sigurimi i aksidenteve dhe i shëndetit me rreth 25% dhe sigurimi Kasko me rreth 18%.

\* Në të ardhurat nga sigurimet vullnetare është përfshirë dhe veprimtaria e risigurimit.






Vlen të theksohet se sigurimi i aksidenteve dhe i shëndetit është linja më dinamike e tregut të sigurimit me një rritje prej 91% për primet e shkruara bruto krahasuar me vitin 2010. Faktorët që kanë ndikuar në këtë dinamikë pozitive janë rritja në veçanti e volumit të primeve të sigurimit të shëndetit privat, produkt i cili është nxitur vitet e fundit nga ekspertiza austriake në treg. Portofoli i sigurimit të aksidenteve dhe shëndetit zë 12% të tregut të Jo-Jetës në total.


### Zhvillimi i tregut të sigurimeve të detyrueshme e vullnetare, 2002-2011

(mln lekë)



### Primet e shkruara bruto të Jo-Jetës, 2007-2011

(mln lekë)




### Primet e sigurimit të Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës në vitin 2011, krahasuar me një vit më parë patën një rritje prej 11%, duke arritur një vlerë prej 0.9 mld lekë. Rritja e primeve të shkruara bruto në vitin 2011 është më e lartë se ajo e vitit 2010, (kur rritja ishte 18% e krahasuar me vitin 2009). Faktori që ka influencuar pothuajse tërësisht në rritjen e sigurimit të Jetës ka qenë rritja e nivelit të kredidhënies. Kështu 32% e rritjes ka ardhur nga portofoli “Sigurime në Grup” dhe 20% e rritjes ka ardhur nga portofoli “Jetë Debitori”, ku përfitues janë bankat e nivelit të dytë, të cilat i akordojnë kredi individëve. Rritja e primeve të shkruara bruto në portofolin e sigurimit “Jetë Debitori” është 3% më shumë se në vitin 2010, e shoqëruar kjo dhe me një rritje të numrit të kontratave në masën 21%.

Primet e shkruara bruto, Jeta, 2002-2011

(mln lekë)






### Shpërndarja gjeografike e sigurimeve

Duke i hedhur një vështrim primit të shkruar bruto sipas shpërndarjes gjeografike, të bie në sy një përqëndrim i tregut të sigurimeve në prefekturat e mëdha.


Një tregues i rëndësishëm i këtij tregu është primi për frymë, i cili për vitin 2011 është rreth 2,937.18 lekë për frymë me një rritje prej 385.58 lekë krahasuar me një vit më parë.

Përsa i përket primit për frymë sipas Prefekturave, prefektura e Tiranës me 6,534.68 lekë për frymë zë vendin e parë e pasuar nga prefektura Gjirokastër me 4,597.77 lekë për frymë dhe më tej Durrësi dhe Vlora përkatësisht me 2,473.42 lekë për frymë dhe 1,884.10 lekë për frymë.



### Shpërndarja e primeve të sigurimit sipas prefekturave


#### Dëmet e paguara sipas prefekturave



## Dëmet


Gjatë vitit 2011, shoqëritë e sigurimeve paguan rreth 2.2 miliard lekë dëme, ose rreth 4% më pak se në vitin 2010. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimeve motorike me 1.7 miliard lekë, apo 78% të totalit. Raporti i ulët dëme/prime tregon se tregu i sigurimeve ka ende shumë për të bërë në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj klientit e publikut në tërësi.

### Struktura e dëmeve të paguara, 2011



### Pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit në vite

(mln lekë)




### Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2011, tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës u nda ndërmjet shoqërive të



sigurimeve Sigal Uniqa Group Austria; Sigma Vienna Insurance Group; Interalbanian; Atlantik; Intersig Vienna Insurance Group; Eurosig; Insig dhe Albsig. Sigal Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me 33% të primeve të shkruara bruto.



Gjatë vitit 2011, aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life Uniqa Group Austria, Sicred dhe Insig. Sigal-Life Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me rreth 54% të primeve të shkruara bruto.

### Risigurimet

Gjatë vitit 2011 shoqëritë e sigurimit kanë kontraktuar rreziqe, të cilat i përkasin sigurimit të aksidenteve dhe shëndetit, sigurimit motorik, sigurimit të marinës dhe aviacionit, sigurimi i zjarrit e dëmtimet në pronë, sigurimi i mallrave në transport, sigurimi i garancive, sigurimi i përgjegjësive publike si dhe ndaj palëve të treta të drejtuesve të automjeteve si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në vendet e tjera anëtare të sistemit të Kartonit Jeshil.

Lidhur me rreziqet e kontraktuara, Autoriteti ka ushtruar mbikëqyrje të vazhdueshme në identifikimin dhe vlerësimin e riskut sipas aktivitetit të biznesit si dhe ka monitoruar vazhdimisht mënyrën e administrimit dhe transferimit të rrezikut në shoqëritë e sigurimit me anë të inspektimeve on-site dhe off-site. Shoqëritë përdorin kapitalet e nevojshme dhe kryejnë transferim të rrezikut për portofole të veçanta sigurimi, në funksion të zbutjes së efekteve financiare prej dëmeve të mëdha. Ky transferim realizohet nëpërmjet bashkësigurimit, kalimit në risigurim të portofoleve të sigurimit në tërësi dhe mbulimit me risigurim fakultativ ose fronting në kontrata të veçanta.

Marrëveshjet risiguroese në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë si të formës jo proporcionale të tipit Excess of Loss, ashtu edhe të formës proporcionale të tipit Quota Share e Surplus.

Ndërkohë, në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguroese të formës proporcionale të tipit Surplus e të tipit Quota Share.

AMF-ja ka monitoruar marrëveshjet risiguroese dhe kontratat fakultative të risigurimit në përputhje me kërkesat ligjore të mbajtjes maksimale për rrezik dhe kritereve të lidhura me cilësinë e risiguroesve. Primet e ceduara në risigurim për vitin 2011 rezultojnë me afro 1.4 mld lekë ose rreth 17% e primeve të shkruara bruto.

Më shumë se 90% e partnerëve risiguroes të shoqërive të sigurimit kanë klasifikim më të lartë se BBB- nga Standard & Poor's, nga ku mbi 50% kanë klasifikim më të lartë se A. Ndër pjesëmarrësit kryesorë në këto programe risigurimi mund të përmendim Munich Re, Hannover Re, Swiss Re, Scor, Lloyd's Syndicates, etj.

### **Krijimi dhe mbajtja e përshtatshme e provigjoneve teknike e matematike të sigurimit**

Një drejtim shumë i rëndësishëm për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes financiare të shoqërive të sigurimit janë analizat periodike lidhur me mjaftueshmërinë e provigjoneve teknike e matematike. Lidhur me këtë, AMF ka monitoruar me kujdes përlllogaritjet e provigjoneve teknike e matematike në çdo tremujor, bazuar në ligjin e sigurimeve dhe rregulloret përkatëse. Në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar janë bërë ndryshime në rregulloren e llogaritjes së provigjonit teknik të sigurimit të Jo-Jetës. Kjo rregullore pasqyron metodologjinë e ndryshuar të kalkulimit të provigjonit teknik të primit të pafituar.

### **Niveli i provigjonit teknik të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit**

Pas heqjes së regjimit të tarifave fikse në gusht të vitit 2011, tendenca në tregun shqiptar të sigurimeve ka qenë drejt uljes së çmimeve, tendencë e kundërt krahasuar me vendet që kanë kaluar më parë këtë proces. Duke u mbështetur në eksperiencën 5-vjeçare të tregut të sigurimeve në Shqipëri, rezultoi se tarifat e propozuara jepnin sinjalin për ulje të likuiditetit për shoqëritë e sigurimeve si dhe rrezikonin përmbushjen e rregullave të menaxhimit të riskut në përputhje me Ligjin Nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime". Për këtë arsye AMF ka monitoruar me bazë ditore situatën në tregun e sigurimeve të detyrueshme motorike.

Pavarësisht tarifave të liberalizuara të primit të sigurimit të detyrueshëm, shoqëritë e sigurimit krijojnë rezervat teknike dhe provigjonet, jo më pak se niveli i rezervave teknike dhe provigjoneve, të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti. Sipas rregullores nr. 110, datë 28.07.2011 për "Përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", Autoriteti përcakton primin e rrezikut për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik jo më pak se një herë në vit, mbi bazën e të cilit llogaritet provigjoni teknik i primit të pafituar.



Llogaritja e provigjionit teknik të dëmeve dhe të primeve kryhet sipas përcaktimeve të Rregullores nr. 9 datë 08.02.2007 të AMF-së “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimit të Jo-Jetës”, e ndryshuar.

Sipas rregullores nr. 110, datë 28.07.2011, shoqëritë e sigurimit i përcaktojnë vetë tarifat e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik. Primi i sigurimit përbëhet nga elementët e përcaktuara në nenin 99 të Ligjit 9267, datë 29.07.2004 dhe shoqëritë e sigurimit mund t'i ndryshojnë, por jo më shpesh se një herë në 6 muaj.

Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin 10 ditë përpara fillimit të zbatimit të tarifave të primeve të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit dhe së bashku me njoftimin depoziton në Autoritet bazat teknike të përdorura, metodikën e përdorur për llogaritjen e primit të sigurimit për produktet e sigurimit të detyrueshëm, si dhe materialet mbështetëse.


Shoqëria publikon primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit në faqen e saj të internetit dhe i mban ato të afishuara në faqe gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Sipas rregullores nr. 110, datë 28.07.2011 për “Përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, roli i komitetit të aktuarëve i ka kaluar shoqatës së aktuarëve. Shoqata e aktuarëve me kërkesë të Autoritetit mund të llogarisë primin e rrezikut për produktet e sigurimit të detyrueshëm si dhe bashkëpunon me Autoritetin dhe ka rol këshillues.

## Të punësuarit në tregun e sigurimeve

Në vitin 2011, numri i të punësuarve\* në industrinë e sigurimeve ishte mesatarisht 1,115 me një tendencë rritjeje prej 4% krahasuar me vitin 2010 dhe 11% krahasuar me vitin 2009.

### Numri i të punësuarve në industrinë e sigurimeve 2009-2011



\* Numri mesatar i të punësuarve me kohë të plotë, sipas degëve të shoqërive të sigurimit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

## II.2 Tregu i letrave me vlerë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione), është segmenti më aktiv në tregun e letrave me vlerë në Shqipëri, ndërsa tregu i aksioneve vazhdon të mbetet ende i pazhvilluar. Ecuria e rezultateve të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë mund të ndiqet me bazë ditore nëpërmjet faqes së Internetit të AMF-së, në rubrikën GSRM.

### Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2011 u dominua në masën 94.41% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 5.59% nga instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 98.72% e të gjitha transaksioneve të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Transaksionet “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dhe “Blerje në tregun primar” dominojnë tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2011, përkatësisht në masën 41.56% dhe 27.30% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 97.51% të të gjitha transaksioneve në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë dominojnë këtë treg në raport me personat juridikë.

**Tabelë 17: Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë**

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
Letra me Vlerë të Qeverisë		2010	2011	'11/'10 - 1
<b>A</b>	<b>Blerje në tregun primar</b>	<b>9,321</b>	<b>8,850</b>	<b>(5.05)</b>
	<i>Individë</i>	5,938	7,260	22.26
	<i>Persona juridikë</i>	3,383	1,590	(53.00)
<b>B</b>	<b>Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar</b>	<b>11,643</b>	<b>6,935</b>	<b>(40.44)</b>
	<i>Individë</i>	7,278	5,781	(20.57)
	<i>Persona juridikë</i>	4,364	1,153	(73.57)
<b>C</b>	<b>Blerje nga individët para afatit të maturimit</b>	<b>4,192</b>	<b>3,108</b>	<b>(25.88)</b>
	<i>Individë</i>	2,747	1,687	(38.61)
	<i>Persona juridikë</i>	1,445	1,421	(1.67)
<b>D</b>	<b>Vendosje e bonove si kolateral</b>	<b>72</b>	<b>53</b>	<b>(26.64)</b>
	<i>Individë</i>	60	36	(40.50)
	<i>Persona juridikë</i>	12	17	44.33
<b>E</b>	<b>Shlyerje e vlerës nominale në maturim</b>	<b>21,828</b>	<b>13,473</b>	<b>(38.28)</b>
	<i>Individë</i>	13,703	11,449	(16.45)
	<i>Persona juridikë</i>	8,125	2,024	(75.09)





## **Platforma GSRM (Tregu me pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë)**

Viti 2011 shënoi vitin e pestë të menaxhimit nga AMF në mënyrë të suksesshëm të platformës GSRM. Gjatë këtij viti, kjo platformë u zgjerua me dy operatorë të rinj, Tirana Bank dhe First Investment Bank, duke e çuar numrin e operatorëve të licencuar për të ushtruar veprimtarinë në këtë treg në 9 (nëntë).

Kjo platformë vazhdon të funksionojë me qëllim që të sigurojë rritjen e transparencës në lidhje me kuotimet dhe transaksionet në tregun me pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë, duke synuar mbrojtjen më të mirë të interesave të investitorëve. Platforma GSRM jep një informacion të plotë dhe të përditësuar për publikun dhe investitorët institucionale në lidhje me kërkesat dhe ofertat ditore në tregun me pakicë të instrumenteve të borxhit të Qeverisë.

Gjatë vitit 2011 në platformën GSRM janë kryer 6,882 klikime ose rreth 6.5% të të gjithë vizitave në faqen zyrtare të AMF-së. Ky numër i lartë i klikimeve tregon interesimin gjithnjë e në rritje të publikut për këtë platformë.

Ndërkohë, emetimi i instrumenteve të rinj si eurobono dhe euro-obligacione u shoqëruan njëkohësisht me implementimin e tyre në platformën GSRM për periudhat përkatëse, në mënyrë që ato të jenë në kohë reale me transaksionet që emetohen. Në këtë platformë, përfshihet dhe një bazë e të dhënave historike, e cila i vjen në ndihmë personave të cilëve u nevojiten të dhëna për qëllime statistikore apo akademike.

Përmirësimi në vazhdimësi i kësaj rubrike me elementë të rinj, do të vijojë të mbetet në fokusin e AMF, në mënyrë që t'i përgjigjet në kohë dhe me cilësi kërkesave të tregut dhe publikut për informacion sa më të plotë e të përditësuar.

## **Tregu i kapitaleve**

AMF-ja, si Autoriteti rregullator dhe mbikëqyrës i tregut të kapitalit është shprehur vazhdimisht për domosdoshmërinë e zhvillimit të këtij tregu dhe rolin e tij në zhvillimin e ekonomisë. Pavarësisht nga kjo, tregu i kapitalit mbetet ende i pazhvilluar. Edhe gjatë vitit 2011, asnjë shoqëri aksionere nuk emetoi aksione nëpërmjet ofertës publike, apo nuk listoi aksionet e saj në Bursën e Tiranës.

Gjatë vitit 2011, Bursa e Tiranës vazhdoi përpjekjet për ndërgjegjësimin e biznesit vendas për avantazhet që krijon tregu i kapitalit si burim për sigurimin e fondeve financiare. Nga ana tjetër, edhe edukimit të investitorëve i është kushtuar kujdesi i nevojshëm në kushtet e rritjes së kursimeve dhe nevojës për më shumë alternativa investimi.

Duke konsideruar faktin se aksionet vazhdojnë të shiten dhe blihen mes individëve jashtë

tregut të organizuar, Autoriteti parashikon formalizimin e këtij tregu nëpërmjet krijimit të një segmenti të posaçëm në Bursën e Tiranës, gjë e cila do të rriste transparencën e këtyre transaksioneve dhe nga ana tjetër do të edukonte biznesin dhe individët me rregullat e tregut.

Aktualisht, mbështetja ligjore dhe institucionale për zhvillimin e tregut të kapitaleve ekziston. Kështu, krahas Bursës së Tiranës, Qendra e Regjistrimit të Aksioneve vazhdon të regjistrojë transaksionet e ndodhura në lidhje me aksionet.

“Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” është shoqëri aksionare, që zotërohet në masën 85% nga shteti shqiptar. Kjo shoqëri është licencuar nga AMF si regjistër i aksioneve. Përveç regjistrimit të pronësisë së kompanive në formë elektronike (Book-Entry), QRA ofron edhe shërbime të tjera për shoqëritë e regjistruara. Në fund të vitit 2011, QRA numëronte 86 shoqëri aksionare të regjistruara.

**Tabelë 18: Të dhëna statistikore mbi transaksionet e regjistruara në QRA për vitin 2011\***

<i>Treguesit</i>	<i>Statistika</i>
1. Nr. total i shoqërive aksionare të regjistruara pranë QRA-së	86
2. Nr. total i aksioneve të shoqërive të regjistruara pranë QRA-së	446 865 951
3. Nr. total i shoqërive, aksionet e të cilave janë tregtuar	33
4. Nr. total i transaksioneve të ekzekutuara gjatë vitit 2011	263
5. Nr. total i aksioneve të tregtuara gjatë vitit 2011	3 973 405
6. Përqindja e transaksioneve të tregtuara gjatë vitit 2011	0.9%

Gjatë vitit 2011, QRA ka reflektuar në regjistrat e aksioneve të shoqërive aksionare 263 transaksione, krahasuar me 602 transaksione të kryera në vitin 2010. Numri i aksioneve të tregtuara jashtë tregut të organizuar gjatë vitit 2011, përbën rreth 0.9% të të gjithë aksioneve të shoqërive të regjistruara pranë QRA-së, çka tregon se volumi i transaksioneve është i ulët.

## II.3 Tregu i pensioneve private vullnetare

Zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit 2011 në tregun e pensioneve private vullnetare ka qenë licencimi i operatorëve, që pritet të luajnë një rol të rëndësishëm në maturimin e këtij tregu duke rritur më tej besueshmërinë e publikut në investimin e fondeve në skemën e pensioneve private vullnetare. Një aspekt i rëndësishëm në punën e AMF-së, pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, ka qenë plotësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor. Skema e re e organizimit dhe funksionimit të pensioneve private vullnetare, e sanksionuar në ligjin e ri, përbën një risi për tregun financiar shqiptar. Në janar të vitit 2011 në treg zhvillonte aktivitetin një operator i licencuar sipas kërkesave të

\*Burimi: Qendra e Regjistrimit të Aksioneve

reja, ndërsa gjatë vitit u licencuan dhe 2 operatorë të tjerë.


Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare në fund të vitit 2011 tregon një total asetesh nën menaxhim prej 155 milion lekë dhe të ardhura neto nga investimet prej afro 8 milion lekë. Vlera mesatare e kontributit mujor të derdhur në fondet e pensioneve private vullnetare gjatë vitit 2011 ka variuar nga 2,000 lekë deri në 13,600 lekë në varësi të fondit, ndërsa numri i anëtarëve aktivë, ose anëtarëve, që kanë kryer të paktën një derdhje kontributi, është 5,275 nga 6,295 anëtarë gjithsej që janë të regjistruar deri më 31 dhjetor 2011 në këto fonde.

**Tabela 19: Tregues të fondeve të pensioneve**


(31.12.2011)

Totali i asetëve* (në mln lekë)	155
Të ardhura neto nga investimet (në mln lekë)	8
Kthimi mesatar nominal neto nga investimet** (në %)	6.8

**Struktura e aktiveve të tregut të fondeve private vullnetare të pensioneve\*\*** (31.12.2011)



**Ecuria e numrit të anëtarëve në fondet private të pensioneve në vite**



\* Shifrat e pasqyruara në tabelë nuk përfshijnë ato të Fondit SiCred Pension, aktiviteti i së cilës do të pasqyrohet në periudhat në vijim, pasi u miratua në fund të vitit 2011.

\*\* Kthimi mesatar nominal nga investimi (%) bazuar në praktikat e OECD, llogaritet si raport ndërmjet të ardhurave neto nga investimi në fund të periudhës dhe nivelit mesatar të asetëve gjatë periudhës.

## Sfida dhe prioritete të AMF-së

AMF synon konsolidimin e të gjitha aspekteve pozitive të arritura që prej krijimit të institucionit në vitin 2006. Edhe gjatë vitit 2012 do të ecet në këtë drejtim. Në këtë vit objektivat janë po aq ambiciozë dhe do të përqendrohen në:

1. Rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të procesit mbikëqyrës;
2. Përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor e rregullativ;
3. Forcimin e pavarësisë dhe transparencës së AMF-së;
4. Rregullimin efektiv të tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik;
5. Zhvillimin teknologjik për të mbështetur aktivitetin mbikëqyrës.

**Rritja e cilësisë dhe efektivitetit të procesit mbikëqyrës** përbën një objektivi pothuaj të përhershëm të AMF-së në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës të tregut financiar jo-bankar. Ky objektivi përmbushet si gjatë përmirësimit të procesit ditor mbikëqyrës, ashtu edhe nga ideimi e zbatimi i një sërë projektsh, kryesisht të natyrës afatmesme. Në vitin 2012 prioritet do të jetë:

- Futja në zbatim e Sistemit të Administrimit të Informacionit. Përmbushja e tij ka qenë objekt afatmesëm për të cilin është punuar ndër vite dhe 2013 synohet të jetë viti i përmbushjes së plotë të tij. Deri tani ka përfunduar faza e testimit nga tregu edhe nga AMF. Për periudhën në vijim AMF do të synojë:
  - Hartimin e manualit të raportimit për tregun e sigurimeve, si hapi i parë i rëndësishëm drejt kalimit të plotë drejt sistemit AMF In-Reg;
  - Konsolidimin e paketës raportuese dhe ndërtim formash të reja në linjë me Planin Strategjik të Zbatimit të metodologjisë me fokus riskun për tregun e sigurimeve;
  - Testimin e vazhdueshëm të formave dhe raporteve statistikore e financiare për shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensione në përputhje me zhvillimet në sistemin AMF In-Reg;
  - Trajnimin e punonjësve në AMF;
  - Mirëmbajtjen dhe administrimin e infrastrukturës hardware dhe software;
  - Helpdesk për përdoruesit e brendshëm dhe/ose të jashtëm mbi përdorimin e sistemit.
- Mbikëqyrja efektive për tregun e sigurimeve me fokus riskun. Puna për realizimin e këtij objektivi afatmesëm ka nisur prej vitesh dhe për periudhën në vijim AMF do të përqendrohet në:
  - Përmbushjen e detyrave sipas Planit Strategjik të Zbatimit të metodologjisë me fokus riskun për tregun e sigurimeve, miratuar nga Bordi i AMF në tetor 2011;



- Rritjen e njohurive të punonjësve në lidhje me mbikëqyrjen me fokus risku dhe trajnimin përkatës të tyre.

**Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor e rregullativ.** Ky përbën një tjetër objektiv të rëndësishëm dhe afatgjatë për AMF-në duke qenë se lidhet me shtyllën e dytë të funksionit të saj, rregullimin. Duke ndjekur këtë objektiv synohet që:

- kuadri ligjor e rregullativ t'i përafrohet direktivave të BE-së, duke kontribuar në këtë mënyrë në procesin e integritit të vendit në BE;
- kuadri ligjor e rregullativ t'i përafrohet standardeve ndërkombëtare të shpallura për mbikëqyrjen e tregjeve financiare jo-bankare;
- të adresohen gjithnjë e më mirë nevojat e brendshme të tregut dhe specifikat e tij.

Gjatë vitit 2012 vëmendja do të përqendrohet në procesin e diskutimit me palët e interesit të projektligjit për sigurimin dhe risigurimin të hartuar në dhjetor të vitit 2011 si edhe diskutimin deri në miratim me ligjvënësin. Ky projektligj është përafuar me direktivat evropiane përkatëse, duke marrë në parasysh edhe praktikatat më të mira të shteteve të tjera të rajonit dhe duke u përshtatur me kërkesat dhe zhvillimet më të fundit të tregut të sigurimeve në vend. Hartimi i kuadrit rregullativ në zbatim të tij, do të jetë gjithashtu pjesë e punës së vitit 2012, megjithëse ky është një proces që vlerësohet se do të kalojë përtej vitit 2012.

AMF-ja gjithashtu synon të hartojë disa amendime në ligjin "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", me qëllim përmirësimin e kuadrit aktual ligjor të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Me synim përfundimtar dhe zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator në fushën e titujve, AMF do të vazhdojë edhe në 2012 hartimin e mëtejshëm të akteve nënligjore në këtë fushë duke përmendur në veçanti hartimin e rregullores për Platformat e Tregtimit Multilaterale dhe "Për emetimin, transferimin dhe ruajtjen si të dhëna elektronike të titujve në regjistrarët e titujve" në zbatim të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për Titujt".

Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor për një mbikëqyrje sa më efektive të tregut financiar jo-bankar dhe adaptimi i proceseve rregullatore dhe mbikëqyrëse të qarta, transparente dhe të qëndrueshme, do të mbeten objektivat kryesore të AMF-së edhe për 2012. Autoriteti do të vazhdojë me prioritet hartimin e akteve nënligjore të tjera në zbatim të ligjeve që rregullojnë fushën financiare jo-bankare.

**Forcimi i pavarësisë dhe transparencës së AMF-së** përbën një objektiv që është risjellë në vëmendje të Autoritetit si pasojë e zhvillimeve në tregun vendas dhe nevojave për t'u përshtatur e paraprirë atyre. BB dhe BE kanë theksuar vazhdimisht nevojën e autoritetit rregullator të pavarur dhe forcimit të kapacitetit administrativ të tij. Parimet ndërkombëtare

të mbikëqyrjes së tregjeve financiare gjithashtu përmbajnë një sërë kërkesash mbi autoritetin, kompetencat, dhe fuqinë e zbatueshmërisë të institucioneve mbikëqyrëse e rregullatore. Të gjitha këto elemente konvergojnë në objektivin e forcimit të pavarësisë institucionale të AMF-së dhe krijimin e garancive për ruajtjen e saj në të ardhmen. Në këtë kuadër gjatë vitit 2012 do të hartohen edhe ndryshime të reja në ligjin “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Rritja e transparencës së AMF-së është një objektivi i inicuar së brendshmi për të kontribuar në rritjen e efektshmërisë së procesit mbikëqyrës. Në këtë aspekt pritet që të shtohet informacioni që i transmetohet publikut duke e thjeshtuar dhe bërë atë më të kuptueshëm edhe për lexuesin joprofesionist; të shtohen kontaktet me median; të rritet vetëdijësimi i konsumatorëve si dhe të shtohet komunikimi me publikun ekspert për çështjet e kryerjes së veprimtarisë kërkimore dhe diskutimit të saj. Ndër veprimtaritë kryesore që mbështesin arritjen e këtij objektivi veçojmë:

- Hartimin e strategjisë së komunikimit me median;
- Rishikimin për të plotësuar e përmirësuar në vazhdimësi strukturën e publikimeve që përgatiten nga AMF, pasurimin e tyre me elementë të rinj dhe ndërtimin e legjendës së botimeve;
- Konceptimin e një plani zhvillimi dhe optimizimi të faqes së Internetit të AMF-së.
- Organizimin e veprimtarisë kërkimore dhe komunikimit të saj me publikun.

**Rregullimi efektiv i tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik** përbën një nga sfidat kryesore të institucionit, që prej krijimit të tij. Ky objektivi merr përparësi në kushtet e heqjes me ligj të regjimit të tarifave fikse në sigurimin e detyrueshëm motorik. Në vijim të strategjisë së AMF në këtë drejtim, me asistencën e Bankës Botërore dhe financim të “First Initiative”, në shtator të vitit 2011, filloi zyrtarisht projekti që do të asistojë AMF në orientimin e drejtë të procesit të liberalizimit. Pritshmëritë e projektit “Strategjia për tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik” janë tepër konkrete, duke i dhënë formë dhe strategjisë që AMF ka patur për liberalizimin e sigurimit të detyrueshëm motorik. Objektivat kryesore të projektit janë:

- Zhvillimi i politikave dhe proceseve drejt tarifimit me bazë riskun të produkteve të sigurimit të detyrueshëm motorik;
- Përafrimi i kuadrit aktual ligjor që rregullon sigurimin e detyrueshëm motorik me direktivat e BE-së.

**Zhvillimi teknologjik për të mbështetur aktivitetin mbikëqyrës** përmban një sërë detyrash ambicioze duke patur parasysh burimet e kufizuara në dispozicion.

Në kuadër të rrugës së zhvillimit drejt zbatimit të sistemit Bonus-Malus në linjë me strategjinë e tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik, për projektin e përgjithshëm të




Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, për vitin 2012, janë parashikuar:

- Ndryshime në Regjistrin Elektronik Online të shitjeve të sigurimeve të detyrueshme motorike. Më specifiku:
  - mundësimi i shfaqjes automatike tek agjentët e shitjes vetëm të të dhënave kryesore të mjeteve motorike, të pronarëve të tyre dhe të kategorizimit të riskut. Ky ndryshim do të mundësojë uljen e kohës së lëshimit të policës, saktësimin e të dhënave si dhe evitimin e rasteve të mosraportimit. Kjo do të bëhet efektive edhe në sajë të bashkëpunimit ndërinstitucional me Ministrinë e Transportit nëpërmjet lidhjes në kohë reale me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor;
  - projektimi i ndërfaqes së përdorimit për Byronë Shqiptare të Sigurimeve (BSHS) me qëllim administrimin e policave dhe saktësimin e lëshimit të tyre.
- Të dhënat e Regjistrin Elektronik Online të shitjeve të sigurimeve të detyrueshme motorike do të shërbejnë për kontrollin në kohë reale nga institucionet në bashkëpunim si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nëpërmjet integritit të kontrollit të vlefshmërisë së policave me sistemin e kontrollit online të vendosur në qendrat operative “eGjoba”;
- Shtesa në Regjistrin e Dëmeve si funksione në shërbim të shoqërive të sigurimit, raporte në shërbim të Autoritetit dhe funksione në shërbim të mirëmbajtjes së tij;
- Gjatë vitit 2012, si rezultat i zbatimit të projektit “Strategjia për tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik” pritet që zgjidhja teknike, e propozuar dhe integruar në Regjistrin Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike dhe Regjistrin e Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, të përdoret si pikënisje për realizimin e tij praktik me qëllim aplikimin e masave të rregullimit efektiv të tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik;
- Do të vazhdojë zgjerimi i “Sistemit SMS i mbështetjes së Konsumatorëve”. Gjatë vitit 2011 është projektuar zgjerimi i “Sistemit SMS i mbështetjes së Konsumatorëve”. Në kuadër të bashkëpunimit me DPShTRr-në gjatë vitit 2012 do të mundësohet edhe lajmërimi i automatizuar disa ditë përpara përfundimit të vlefshmërisë së taksave të qarkullimit, kolaudimit apo sigurimit të detyrueshëm.

# SHTOJCA A

## Struktura e AMF





## Të Përgjithshme

Referenca Ligjore/Rregullative	Emërtimi	Përshkrimi i Ligjit/Rregullores
Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006	“Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”	Qëllimi i këtij ligji është krijimi i Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare, si institucioni i vetëm kompetent për licencimin e subjekteve në fushën financiare jo-bankare dhe mbiqëqyrjen e veprimtarisë së këtij tregu.
Ligji nr. 10 158, datë 15.10.2009	“Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore”	Ligji për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore ka si qëllim përmirësimin e bazës ligjore, zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe mbrojtjen e investitorëve. Ligji zbatohet për obligacionet: a) e shoqërisë aksionare, me zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë; b) e qeverisë vendore. Ky ligj nuk zbatohet në rastet e obligacioneve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë apo të Bankës së Shqipërisë.
Rregullore nr. 37/1, datë 23.02.2011	“Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në AMF”	Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për kushtet, procedurat, të drejtat dhe detyrimet, e pranimit, fillimit, vazhdimin dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës së punonjësve në AMF.
Rregullore nr. 37/2, datë 23.02.2011	“Kodi i Etikës në AMF”	Kodi i Etikës ka si qëllim që të shërbejë si udhëzues për të gjithë punonjësit e AMF-së lidhur me veprimet e përditshme apo me vendimmarrjen në përputhje me misionin, parimet drejtuese dhe vlerat e punonjësve. Kodi i Etikës shërben si një urë lidhëse ndërmjet integritetit personal e profesional në veprimet e përditshme të punonjësve dhe shpreh angazhimin e tyre ndaj Misionit të Autoritetit.
Rregullore nr. 56, datë 30.03.2011	“Për funksionimin dhe administrimin e ambienteve të Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare”	Rregullorja ka për objekt përcaktimin e rregullave për funksionimin, administrimin, sigurinë, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e ambienteve të punës dhe pajisjeve në AMF.
Rregullore nr. 83, datë 29.06.2011	“Për marrëdhëniet financiare të punonjësve me Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”	Rregullorja ka për qëllim përcaktimin e rregullave që dispijonojnë mënyrën e përcaktimit dhe masën e shpërbërimit dhe shpenzimeve për punonjësit e Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare.
Rregullore nr. 118, datë 19.09.2011	“Karta e auditimit të brendshëm”	Rregullorja përcakton misionin, qëllimin, objektivat e punës dhe përgjegjësitë e funksionit të auditimit të brendshëm në Autoritet, të përcaktuara në përkufizimin, standardet ndërkombëtare dhe kodin e etikës, që drejtojnë praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.
Rregullore nr. 119, datë 19.09.2011	“Kodi i Etikës së Audituesit të Brendshëm”	Rregullorja ka për qëllim të promovojë një kulturë etike në ushtrimin e auditimit të brendshëm.
Rregullore nr. 177, datë 13.12.2011	“Mbi organizimin e veprimtarisë kërkimore në Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”	Rregullorja ka për objekt të përcaktojë normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin e veprimtarisë kërkimore të AMF-së, detyrat funksionale të përgjithshme dhe të vecanta të çdo individi dhe njësisë që angazhohet në këtë veprimtari.
Rregullore nr. 14, datë 25.02.2009	“Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”	Qëllimi rregullores është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut, nga zyrtarët publikë të AMF-së, nëpërmjet përcaktimit të rregullave për llojet e interesave që mund të bëhen shkak për lindjen e konfliktit të interesave.
Rregullore nr. 61, datë 22.05.2008	“Për procedurat e trajtimit të ankesave të të siguruarve”	Kjo rregullore ka si qëllim të përcaktojë kushtet dhe rregullat e përgjithshme për trajtimin e ankesave të të siguruarve.

# SHTOJCA B

## Kuadri ligjor/rregullativ në sektorin financiar jo-bankar



Regullore nr. 114, datë 11.09.2008	“Për Konfidencialitetin në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”	Objekt i kësaj rregulloreje është klasifikimi, ruajtja dhe administrimi i informacionit publik në AMF
Regullore nr. 17, datë 21.03.2007	“Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuar dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”	Kjo rregullore përcakton mënyrën e mbajtjes dhe ruajtjes së regjistrave nga AMF, si dhe konsultimin e publikut me këto të dhëna.
Regullore nr. 7, datë 30.08.2007	“Për rregullat e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”	Kjo rregullore synon të përcaktojë normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e administratës së AMF-së, detyrat funksionale të përgjithshme dhe të veçanta të çdo departamenti, drejtorie, sektori e punonjësi.
Regullore nr. 3, datë 02.11.2006	“Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”	Kjo rregullore ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve të anëtarëve të Bordit të AMF-së dhe marrëdhënieve midis këtyre të fundit dhe administratës së Autoritetit.

## Në Fushën e Sigurimeve

### Referenca Ligjore/Rregullative

#### Emërtimi

Ligji nr. 10 076, datë 12.02.2009	“Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”	Qëllim i këtij ligji është përmirësimi i bazës ligjore të sigurimit të detyrueshëm. Ky zhvillim ligjor ndërmerret në një kohë kur tregu i sigurimeve ka avancuar me shpejtësi dhe kërkohen ndryshime ligjore në përgjigje të këtij zhvillimi, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare.
Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004	“Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”	Objekt i këtij ligji është vendosja e parimeve dhe rregullave të përgjithshme për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime dhe mbikëqyrjen nga shteti të subjekteve që marrin përsipër të ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj.
VKM nr. 5, datë 07.01.2009 propozuar me vendim Bordi nr. 166, datë 23.12.2008	“Për disa ndryshime në Vendimin nr. 96, datë 03.08.2008 të Këshillit të Ministrave “Për aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimeve”	Ndryshimet në VKM nr. 96, datë 03.08.2008, kanë për qëllim rritjen e kufirit të sipërm të lejueshëm për investimin e provigjoneve teknike e matematike në toka dhe ndërtime, i cili do të jetë në masën 30 përqind, nisur dhe nga mundësitë e kufizuara të investimit brenda vendit.
VKM nr. 79, datë 28.01.2008 propozuar me vendim Bordi nr. 4, datë 30.08.2007	“Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime, si dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës”	VKM përcakton kriteret dhe procedurat për licencimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së brokerimit në sigurime dhe në kriteret për licencimin e aktivitetit të agjentit në sigurime.
VKM nr. 164, datë 28.01.2008, propozuar me vendim Bordi nr. 3, datë 30.08.2007	“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime”	VKM parashikon dispozita të përgjithshme ku krahas karakteristikave të licencës përcaktohen kufizime lidhur me aktivitetet e tjera detyruese që mund të ushtrohen vlerësuesi, të cilat sipas projektit duhet të jenë vetëm ato që ushtrohen në pajtim me natyrën e profesionit të tij.
VKM nr. 96, datë 03.02.2008, propozuar me vendim Bordi nr. 3, datë 18.06.2007	“Për aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimit”	VKM përcakton mbulimin e provigjoneve teknike dhe matematike si pjesën më të rëndësishme të përgjegjesive të një shoqërie sigurimi, duke përfqësuar detyrimet e tyre që lidhen drejtpërdrejt me kontratat e sigurimit.
VKM nr. 191, datë 25.03.2005	“Për miratimin e metodikës mbi mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e Jetës dhe Jo-Jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbëjnë atë”	Në vendim përcaktohet mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e Jetës dhe Jo-Jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbëjnë atë.

### Përshkrimi i Ligjit/Rregullores



Regullore nr. 110, datë 28.07.2011	"Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit"	Rregullorja përcakton nivelin e provigjoneve teknike, përmbajtjen e bazës teknike të të dhënave, metodikën për përlogartjen e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.
Regullore nr. 26 datë 23.02.2011	"Regullore nr. 26, datë 23.02.2011 "Mbi funksionimin e sistemit të raportimit AMF In-Reg"	Rregullorja ka për objekt organizimin, funksionimin dhe përcaktimin e procedurave të sistemit të raportimit AMF In-Reg.
Regullore nr. 22, datë 19.03.2010	"Mbi krijimin, llogartjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve"	Kjo rregullore përcakton rregullat në lidhje me administrimin e Fondit të Kompensimit.
Regullore nr. 21, datë 19.03.2010	"Mbi administrimin e fondit të garancisë dhe rregullat e trajtimit të dëmeve të kartonit Jeshil"	Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë rregullat mbi administrimin e Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil për të garantuar detyrimet financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil dhe kriteret bazë të pajisjes së anëtarëve me certifikatë ndërkombëtare sigurimi, në momentin e aplikimit dhe në vazhdim.
Regullore nr. 20, datë 19.03.2010	"Mbi masën e kontributit vjetor të shoqërive të sigurimit"	Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e masës së kontributit vjetor që i paguhet AMF-së nga shoqëritë e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj, gjatë ushtrimit të aktivitetit sigurues.
Regullore nr. 2, datë 28.01.2010	"Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit, përmbajtjen dhe afatet e raportimit të saj pranë Autoritetit."	Kjo rregullore përcakton rregullat dhe standardet e mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit, përmbajtjen dhe afatet e raportimit të saj pranë Autoritetit.
Regullore nr. 75, datë 28.08.2009	"Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit"	Kjo rregullore përcakton nivelin e primeve dhe të provigjoneve teknike, përmbajtjes së bazës teknike të të dhënave, metodikave për përlogartjen e primeve dhe provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit. Në rregullore përcaktohet gjithashtu procedura dhe afate për miratimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të tabelave të primeve të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.
Regullore nr. 67, datë 27.07.2009	"Mbi licencimin e aktuarëve të autorizuar të shoqërive të sigurimit"	Kjo rregullore përcakton kriteret dhe kushtet për dhënien dhe tërheqjen e autorizimit të aktuarit, si dhe përcaktimi i detyrave të tij.
Regullore nr. 53, datë 25.06.2009	"Për trajtimin e dëmeve që mbuloohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit"	Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat e trajtimit të dëmeve, që mbuloohen nga kontrata e sigurimit të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, përgjegjësisë së pronarit ose përdoruesit të mjeteve motorik, përgjegjësisë së pronarit ose përdoruesit të avionit, përgjegjësisë së pronarit ose përdoruesit të mjeteve lundrues.
Regullore nr. 36, datë 30.04.2009	"Për regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike"	Kjo rregullore përcakton mënyrën dhe procedurat për raportimin e dëmeve të sigurimeve të detyrueshme përmes një regjistri elektronik të instaluar në serverat e qendrës së informacionit të sigurimeve të detyrueshme.
Regullore nr. 61, datë 22.05.2008	"Për procedurat e trajtimit të ankesave të të siguruarve"	Kjo rregullore ka si qëllim të përcaktojë kushtet dhe rregullat e përgjithshme për trajtimin e ankesave të të siguruarve.
Regullore nr. 10, datë 03.10.2007	"Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik"	Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës dhe procedurave për identifikimin dhe raportimin e shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik, përmes një regjistri elektronik të instaluar në serverat e AMF-së.
Regullore nr. 2, datë 18.06.2007	"Për kriteret e risigurimit"	Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë kriteret mbi bazën e të cilave lidhen marrëveshje risigurimi nga shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.
Regullore nr. 14, datë 08.02.2007	"Për disa kriteret që duhet të plotësojnë personat e zgjedhur ose të emëruar në organet drejtuese të shoqërive të sigurimit ose risigurimit"	Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave në lidhje me profesionalizmin dhe me reputacionin e personave që kryejnë administrimin, drejtimin dhe kontrollin e shoqërisë së sigurimit, si dhe kufizimet që duhet të zbatohen në emërimin dhe në shkarkimin e tyre.
Regullore nr. 13, datë 08.02.2007	"Për procedurat e pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi ose risigurimi në Republikën e Shqipërisë"	Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë afatet dhe procedurat e dhënies së licencës për të ushtruar veprimtari si shoqëri sigurimi ose risigurimi dhe degë e shoqërisë së sigurimit të huaj, procedurat e krijimit të zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë nga shoqëria e huaj e sigurimit, si dhe procedurat për licencimin e zgjerimit të veprimtarisë së sigurimit të shoqërisë së sigurimit.



Regullore nr. 9, datë 08.02.2007	“Mbi bazat, metodat e llogaritjes, si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës nga shoqëritë e sigurimit.”	Objekti kësaj rregulloreje është mënyra llogaritjes dhe mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës nga shoqëritë e sigurimit.
Regullore nr. 8, datë 08.02.2007	“Mbi bazat, metodat e llogaritjes, si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike”	Objekti kësaj rregulloreje është mënyra e llogaritjes dhe mbajtjes së provigjoneve matematike nga shoqëritë e sigurimit.
Regullore nr. 7, datë 08.02.2007	“Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit”	Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktohen kriteret dhe procedurat për shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar, që do të emërohen nga shoqëritë e sigurimit pas aprovimit nga AMF dhe përmbajtja e raporteve të kontrollit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar. Ndryshimet konsistojnë në periudhën që një shoqëri ekspertësh kontabël të jetë jo më e gjatë se katër vjet në vazhdim nga momenti i miratimit të saj.
Regullore nr. 6, datë 08.02.2007	“Për rregullat, mënyrat dhe kushtet e raportimit të shoqërive të sigurimit në AMF”	Objekti i kësaj rregulloreje janë rregullat e vendosura nga AMF për mënyrën e raportimit të shoqërive të sigurimit.
Regullore nr. 5, datë 08.02.2007	“Mbi përmbajtjen e programit të risigurimit të shoqërive të sigurimit dhe afatet kohore të paraqitjes pranë AMF-së”	Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë rregullat bazë për hartimin e programit të nevojave për risigurim për çdo vit financiar të shoqërisë së sigurimit.
Regullore nr. 4, datë 08.02.2007	“Për kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit”	Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e ekuilibrit për aktivitetin e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit dhe të respektimit të detyrueshëm të disa raporteve mbikëqyrëse.
